VENDIM
Nr.43, datë 15.03.2017

MBI MIRATIMIN PËRFUNDIMTAR TË CERTIFIKIMIT TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE OST SH.A. NË PËRPUTHJE ME NENIN 54, PIKA 6, TË LIGJIT NR. 43/2015, "PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE" DHE NENIN 9, PIKA 6, TË DIREKTIVËS 72/2009 EC MBAS MARRJES SË OPINIONIT TË SEKRETARIATIT TË KOMUNITETIT TË ENERGJISË

Në mbështetje të nenit 3, pika 8; nenit 16; nenit 54 dhe 58, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", vendimit të Këshillit Ministerial nr. D/2011/02/MC-EnC, Traktatit të Komunitetit të Energjisë, të ratifikuar me ligjin nr.9501, datë 3.4.2006, si dhe neneve 6, 8, 9 pika 1, neni 10, 11, 12 dhe 14 të rregullave "Për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin nr. 154 datë 11.12.2015, të Bordit të ERE-s, nenit 3, pika 1, germa "b", dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.96, datë 17.6.2016, Vendimit të ERE nr.160 datë 5.10.2016, dhe Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë të datës 24 janar 2017,

duke konsideruar se:

- Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" është përafruar me direktivën 2009/72/KE, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 13 korrik 2009, "Mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike", përfshirë kërkesat e parashikuara për certifikimin e operatorëve të sistemit të transmetimit;

- Në bazë të nenit 54, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", Operatori i Sistemit të Transmetimit ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga veprimtaritë e tjera në Sektorin e Energjisë Elektrike, si prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

- Në nenin 58 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", përcaktohet se, para se të licencohet për kryerjen e veprimtarisë së operimit të sistemit të transmetimit, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të certifikohet sipas procedurës së përcaktuar në këtë nen. ERE përcakton kërkesat për aplikimin për certifikim të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, përfshirë dokumentacionin e nevojshëm që provon përmbushjen e kushteve, sipas nenit 54 të këtij ligji. Aplikimi për certifikim, paraqitet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, në përputhje me kërkesat e miratuara nga ERE. Në këtë nen përcaktohet, gjithashtu, se:

- ERE merr një vendim lidhur me certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit brenda 4 muajve nga data e aplikimit dhe dorëzimit të të gjithë dokumentacionit dhe informacionit të kërkuar.

- ERE mund të kërkojë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e këtij detyrimi.

- ERE njofton Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë për certifikimin paraprak të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe merr vendim final brenda 2 muajve nga data e marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, duke marrë në konsideratë rekomandimet e tij.

- Nëse vendimi përfundimtar i ERE-s është i ndryshëm nga opinioni i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ERE duhet të publikojë dhe të arsyetojë shkaqet e mospranimit të tyre, duke informuar Sekretariatin për këtë vendim.

- ERE monitoron përputhshmërinë e veprimtarisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit me kërkesat e përcaktuara në ligjin për sektorin e energjisë elektrike. ERE rishikon procedurën e certifikimit, të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në rastet e mëposhtme:

a) pas njoftimit nga ana e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, në përputhje me pikën 8 të këtij

neni;

b) me nismën e tij, kur ka një dyshim të arsyeshëm se një ndryshim i planifikuar ndikon në të drejtat ose në kontrollin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe mund të çojë në shkelje të dispozitave të nenit 64 ose në rastet kur një shkelje e tillë mund të ketë ndodhur;

- Në bazë të nenit 54, pikat 3, 4, 5, 6, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", përcaktohet se:

Duke filluar nga data 1 janar 2016, i njëjti person nuk ka të drejtë që në të njëjtën kohë:

a) të ushtrojë kontroll, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbi një të licencuar, që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror dhe të ushtrojë kontroll ose ndonjë të drejtë tjetër ndaj Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose rrjetit të transmetimit;

b) të ushtrojë kontroll, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe të ushtrojë kontroll ose të ushtrojë ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror;

c) të emërojë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, Bordit Drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht Operatorin e Sistemit të Transmetimit apo rrjetin e transmetimit dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të ushtrojë kontroll apo ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror;

ç) të jetë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, Bordit Drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licencuarin pranë të licencuarve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit ose furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror dhe veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose rrjetit të transmetimit.

- Neni 54/4 i ligjit: Ndalimet e parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të paragrafit më sipër do të zbatohen në mënyrë të veçantë, për:

a) kompetencën për të ushtruar të drejtën e votës;

b) kompetencën për të emëruar anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, Bordit Drejtues ose organeve që përfaqësojnë të licencuarin;

c) të drejtën e mbajtjes së një pjese të shumicës së aksioneve.

- Neni 54/5 i ligjit: Detyrimi i parashikuar më sipër, konsiderohet se është përmbushur, nëse dy ose më shumë shoqëri, të cilat kanë rrjetet e tyre të transmetimit, kanë krijuar një sipërmarrje të përbashkët, e cila vepron si një operator i sistemit të transmetimit në dy ose më shumë shtete. Asnjë shoqëri tjetër nuk mund të jetë pjesë e kësaj sipërmarrjeje të përbashkët, përveç rastit kur shoqëria është përcaktuar si operator i pavarur i sistemit të transmetimit dhe është certifikuar sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

- Neni 54/6 i ligjit: Kur personi i përmendur në paragrafin me sipër, është një organ publik që kontrollohet nga shteti, atëherë dy organe të veçanta publike që ushtrojnë kontroll, njëri mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe tjetri mbi të licencuarin që kryen funksionin e prodhimit ose të furnizimit të energjisë elektrike, do të konsiderohen sikur nuk janë i njëjti person.

- Neni 53, i ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" kërkon që Operatori i Sistemit të Transmetimit të funksionojë si person juridik i licencuar për kryerjen e veprimtarisë së transmetimit të energjisë elektrike, i cili ka në pronësi sistemin e transmetimit dhe respekton parimin e pavarësisë, të përcaktuar në nenin 54 të ligjit siç cituar më sipër.

Sa më sipër, përmbush kriteret lidhur me themelimin e operatorit në një nga format ligjore të parashikuara dhe moskrijimin e konfuzionit në lidhje me identitetin e tij, i cili duhet të jetë qartësisht i dallueshëm nga i ndërmarrjeve të tjera,

- Neni 56 i ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" ka përcaktuar përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit në përputhje me detyrat e përcaktuara në ligj.

- Në çdo rast, bazuar në nenin 58, pika 9, të ligjit nr. 45/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe

në përputhje me nenin 14 të rregullores "Për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 154, të datës 11.12.2015, ERE, monitoron përputh-shmërinë e veprimtarisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike dhe rishikon procedurën e certifikimit.

Duke konsideruar se:

- Në përputhje me sa përcaktuar në nenin 8, germa "a", të rregullores "Për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 154, datë 11.12.2015, ku përcaktohen kriteret që duhet të përmbushen nga aplikuesi për të mundësuar vendimmarrjen dhe certifikimin e tij nga rregullatori, të cilat ndër të tjera konsistojnë në:

a) Personi juridik që ka pronësinë mbi Opera-torin e Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike nuk duhet të ketë të drejta kontrolli të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në aktivitetet e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit apo anasjelltas;

- Në nenin 7 të rregullores së sipërcituar, përcaktohet se, në vijim të zbatimit të të gjitha kërkesave për ndarjen e aktivitetit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, shoqëria aplikuese duhet të njoftojë ERE me shkrim dhe duhet të paraqesë:

- kërkesën me shkrim për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike;

- dokumentet, të dhënat dhe informacionet e përmendura në kapitullin III të rregullores; dhe

- Pyetësorin e plotësuar për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, sipas modelit të dhënë në shtojcën e kësaj rregulloreje, përveç rasteve kur shoqëria që ka paraqitur kërkesën është OST e përjashtuar sipas nenit 32, vendimi i përjashtimit të të cilit parashikon një model ndarje të aktivitetit që nuk përcaktohet në ligj dhe pyetësori duhet të hartohet nga ERE në bashkëpunim me Sekretariatin.

- Në nenin 8 të rregullores "Për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike", janë vendosur kritere që duhet të përmbushen nga aplikuesi për të mundësuar vendimmarrjen dhe certifikimin. Në nenin 11, përcaktohet se ERE do të certifikojë operatorin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, bazuar në procedurat e vendosura në nenin 58, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë Elektrike" dhe në përputhje me këtë rregullore.

Referuar rregullores "Për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike", pjesa shtojca, aplikuesi duhet të plotësojë pyetësorin për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike, sipas modelit të dhënë në shtojcën e kësaj rregullore.

- Paraqitja e aplikimit

- Siç cituar më sipër, shoqëria Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike sh.a., me shkresën nr. 4179 prot, datë 13.7.2016, regjistruar në ERE me nr. 545 prot, datë 13.7.2016, ka paraqitur kërkesën për certifikimin në aktivitetin si Operator i Sistemit të Transmetimit (OST-E), bazuar në nenet 54 dhe 58, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

- Kjo kërkesë është shoqëruar me informacionin e nevojshëm, referuar "Rregullave për Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 154, datë 11.12.2015, si dhe pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 27.4.2016 "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike", e cila përcakton se: "menjëherë mbas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, OST-ja aplikon në ERE për certifikim në bazë të nenit 58, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike".

- Për qëllime të këtij aplikimi, OST sh.a., ka depozituar në ERE, dokumentacionin e listuar sa më poshtë:

- Formularin ku identifikohen dokumentet, të dhënat dhe/ose informacioni i paraqitur nga OST sh.a., në aplikim, i cili duhet të trajtohet si informacion konfidencial ose informacion i ndjeshëm tregtar.

- Deklarata e administratorit të OST sh.a. dhe drejtorit të Drejtorisë Ligjore, sipas neni 9.1/p/iii të rregullores së miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 154, datë 11.12. 2015.

- Ekstrakt i Regjistrit Qendror të Biznesit të Malit të Zi për SEE CAO, të datës 8.7.2016 (kopje të

noterizuara në gjuhën malazeze, shqipe dhe angleze).

- Ky aplikim është shoqëruar me dokumenta-cionin e parashikuar në nenin 9 dhe pjesën shtojca të "Rregullave për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike", miratuar me vendimin e bordit të ERE, nr. 154, datë 11.12.2015.

- Aplikuesi ka dhënë informacion të plotë mbi emrin e kompanisë, regjistrimin si person juridik, si dhe të dhënat në lidhje me identifikimin e tij si subjekt juridik pranë organeve tatimore (NUIS), të dhëna mbi kapitalin dhe aksionarin e vetëm të saj, vlerën nominale, të dhënat e kontaktit, adresën, përfaqësuesin e kompanisë në marrëdhëniet me të tretët etj. Referuar sa më sipër, rezulton i paraqitur në përputhje me rregulloren, informacioni i përgjithshëm i kërkuar.

- Referuar pikës II, në pjesën shtojca, aplikuesi ka plotësuar formularin e ndarjes së pronësisë (*Ownership Unbundling).*

- Në bazë të nenit 54/1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", Operatori i Sistemit të Transmetimit ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga veprimtaritë e tjera në sektorin e energjisë elektrike, si prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

- Aktualisht, OST-ja është licencuar për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike referuar vendimit të ERE-s nr. 24, datë 26.3.2009 "Për rinovimin e licencës në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike". Sa u takon aktiviteteve të tjera, si: prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi, OST sh.a. nuk rezulton të ushtrojë këto aktivitete.

Për sa përcaktuar në pikën 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 27.4.2016, "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike", tanimë rezulton aksionar i vetëm i OST sh.a. me kapital 100% shtetëror MZHETS (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes).

Gjithashtu, në pikën 1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 27.4.2016, është përcaktuar se:

"Autoriteti publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. është MEI (Ministria e Energjisë dhe Industrisë)."

Në vijim, në pikat 3 dhe 5, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 27.4.2016, është përcaktuar se:

"3. Ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, emërojnë anëtarët e këshillave mbikëqyrës të shoqërive të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 brenda tridhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi duke zbatuar kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike".

5. Ministria e Energjisë dhe Industrisë ushtron të drejtat mbi OST-në në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe fushën e tij të përgjegjësisë shtetërore.".

Pra, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (këtu e më poshtë **"MZHETS"** apo **"Ministria e Ekonomisë"**) ushtron kontroll të drejtpërdrejtë në cilësinë e pronarit për OST sh.a.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë ushtron kontroll të drejtpërdrejtë në cilësinë e pronarit për Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. dhe Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. Nga sa më sipër, si dhe duke qenë se aktivitetet e transmetimit, prodhimit dhe furnizimit të energjisë elektrike zhvillohen nga subjekte të organizuara në formën e shoqërive tregtare (shoqëri aksionare shtetërore), autoritetet e përmendura me lartë, kryejnë funksionin e Asamblesë së Aksionarëve për shoqëritë respektive, duke marrë çdo vendim që ka në kompetencë Asambleja e Aksionarëve në një shoqëri anonime sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes janë dy organet të larta të administratës shtetërore të organizuara sipas ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".

Ligji nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" rregullon organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, nëpërmjet përcaktimit të kritereve për krijimin dhe funksionimin e institucioneve shtetërore.

Në nenin 4, organet dhe institucionet e administratës shtetërore është përcaktuar se:

1. Kryeministri dhe ministrat janë organet e larta të administratës shtetërore. Ata drejtojnë dhe mbikëqyrin administratën shtetërore brenda fushës përkatëse të veprimtarisë shtetërore.

2. Administrata shtetërore përbëhet nga këto institucione:

a) Kryeministria;

b) Ministritë;

c) institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave;

ç) njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve;

d) agjencitë autonome;

dh) administrata e prefektit.

Marrëdhëniet midis ministrive dhe Këshillit të Ministrave, përcaktohen në nenin 5, ministritë, si më poshtë:

1. Çdo ministri drejtohet dhe përfaqësohet nga ministri, në vazhdim ministri përgjegjës. Ministri është përgjegjës përpara Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit për tërësinë e veprimtarisë së ministrisë, institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome, më poshtë "sistem ministror", brenda fushës përkatëse të veprimtarisë shtetërore.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, përcakton fushën e veprimtarisë shtetërore në përgjegjësinë e çdo ministrie, në vazhdim "fusha e përgjegjësisë shtetërore".

3. Ministria kryen të gjitha funksionet administrative brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë shtetërore, përveç atyre që u delegohen shprehimisht institucioneve të varësisë apo u ngarkohen me ligj agjencive autonome.

Pra, sa më sipër, secila prej ministrive kryen të gjitha funksionet administrative brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë shtetërore. Fusha përkatëse e përgjegjësisë për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë është përcaktuar në vendimin nr. 833, datë 18.9.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë" dhe konkretisht:

II. Ministria e Energjisë dhe Industrisë harton dhe zbaton politika që synojnë garantimin e furnizimit me energji të vendit, shfrytëzimin e burimeve energjetike e minerare në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe dobishmërisë publike, si dhe nxitjen e zhvillimit industrial me standarde sa më miqësore për mjedisin.

III. Ministria e Energjisë dhe Industrisë ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

1. sektorin e energjisë elektrike;

2. sektorin e hidrokarbureve (naftë dhe gaz);

3. sektorin e minierave dhe gjeologjisë;

4. sektorin e industrisë joushqimore.

Legjislacioni përkatës në bazë të të cilit ushtron veprimtarinë e saj Ministria e Energjisë dhe Industrisë në sektorin e energjisë elektrike është ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe aktet nënligjorë të dala në zbatim të tij.

Konkretisht roli i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë në raport me OST sh.a. është i përcaktuar në

nenet si më poshtë të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike";

Në nenin 4 "Politikat e sektorit të energjisë elektrike"

1. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për politikat e përgjithshme të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike të Shqipërisë, në përputhje me politikat e zhvillimit ekonomik dhe sektorët e tjerë të vendit.

2. Ministria përgjegjëse për energjinë:

a) harton Strategjinë Kombëtare të Energjisë, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe përditësohet të paktën çdo pesë vjet. Strategjia Kombëtare e Energjisë përcakton objektivat e zhvillimit të sektorit të energjisë, si dhe rrugët e arritjes së tyre, duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë kombëtare për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë;

b) harton programet afatmesme për zhvillimin e sektorit të energjisë elektrike, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë;

c) vlerëson nevojën e ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese dhe fuqizimin e rrjeteve, në përputhje me programet afatmesme, duke marrë parasysh:

i) bilancet e përgjithshme të pritshme të energjisë elektrike në të ardhmen;

ii) sigurinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike;

iii) koston, duke përfshirë çdo mekanizëm të minimizimit të saj, për këto kapacitete të reja prodhuese;

ç) mbikëqyr zbatimin e politikave dhe programeve të zhvillimit të sektorit energjetik, në përputhje me zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Në nenin 5 "Të dhëna dhe informacione për bilancin e energjisë elektrike"

1. Çdo person fizik ose juridik që prodhon, transmeton, shpërndan, importon, eksporton ose furnizon energji elektrike është i detyruar të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për energjinë të dhëna lidhur me veprimtarinë e tij, me qëllim hartimin e politikave të zhvillimit të sektorit energjetik dhe komunikimin me institucionet e specializuara, në kuadrin e angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë, si dhe përgatitjen dhe publikimin e bilancit vjetor energjetik.

2. Ministri përgjegjës për energjinë miraton mënyrën dhe formatin e raportimit të të dhënave.

Në nenin 6 "Rregullat e sigurisë së furnizimit me energji elektrike"

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë, në bashkëpunim me institucionet ose entet e tjera që veprojnë në sektorin e energjisë elektrike, miraton rregullat për sigurinë e furnizimit me energji elektrike, të cilat përfshijnë:

a) masat për sigurinë e furnizimit me energji elektrike;

b) masat që ndërmerren për rastet kur rrezikohet siguria e furnizimit;

c) masat që ndërmerren për rastet e situatave emergjente;

ç) rolin dhe detyrimet e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, në lidhje me sigurinë e furnizimit me energji elektrike.

Në nenin 31 "Ndërtimi i interkonektorëve të rinj"

1. Linjat e reja të interkoneksionit që ndërtohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit apo nga investitorët privatë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë.

Në nenin 33 "Linjat direkte"

1. Të gjithë prodhuesit dhe furnizuesit e energjisë elektrike brenda një territori të caktuar mund të furnizojnë mjediset e tyre, filialet dhe klientët e tyre, nëpërmjet një linje direkte.

2. Linjat direkte, që ndërtohen për eksportimin e energjisë elektrike nga prodhuesi vendas drejt një konsumatori jashtë vendit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, pas marrjes së mendimit nga ana e ERE-s.

3. Linjat direkte, të cilat ndërtohen për lidhjen e një prodhuesi brenda vendit me një konsumator brenda vendit apo një shoqëri furnizimi që furnizon mjediset e veta apo klientët e vet të kualifikuar, miratohen nga ministri përgjegjës për energjinë, pas marrjes së mendimit nga ana e ERE-s.

4. Kushtet dhe procedurat për ndërtimin e linjave direkte, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Ministri miraton ndërtimin e një linje direkte, edhe në rastet kur aplikuesit i është refuzuar aksesi në rrjet për rastet e parashikuara në nenin 29, të këtij ligji, ose nëse është iniciuar një procedurë për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, sipas parashi-kimeve të nenit 24 të këtij ligji.

6. Ministri refuzon ndërtimin e një linje direkte në rast se dhënia e një autorizimi të tillë, pengon përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik dhe mbrojtjen e klientit, të përcaktuara sipas dispozitave të këtij ligji. Argumentet për një refuzim të tillë duhet të jenë të arsyetuara dhe i njoftohen aplikuesit.

Në nenin 34 "Standardet teknike dhe të sigurisë në sektorin elektrik".

1. Rregullat teknike për projektimin, ndërtimin dhe operimin e centraleve të prodhimit të energjisë elektrike, sistemit të transmetimit, sistemit të shpërndarjes, linjave të interkoneksionit ose linjave direkte në Republikën e Shqipërisë, përfshirë edhe rregullat e sigurimit teknik, hartohen nga ministri përgjegjës për energjinë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardeve dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Kontrolli i zbatimit dhe mbikëqyrja e rregullave teknike të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, për sektorin e energjisë elektrike, kryhen nga inspektorati përgjegjës në varësi të ministrit përgjegjës për energjinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në nenin 60 "Zhvillimi i rrjetit të transmetimit"

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit harton një plan dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit, në konsultim me palët e interesuara, dhe e paraqet për miratim në ERE.

6. Kur ERE konstaton se Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka realizuar për tri vite, një investim të parashikuar sipas planit 10-vjeçar, dhe gjykon se investimi është i nevojshëm dhe mund të financohet pa penguar operimin normal të rrjetit, i kërkon atij të marrë një nga këto masa:

a) të realizojë investimin në fjalë;

b) të organizojë një procedurë konkurruese për realizimin e investimit në fjalë, të hapur ndaj çdo investitori;

c) të pranojë rritjen e kapitalit, me qëllim financimin e investimeve të nevojshme.

7. Kur ERE merr masa, sipas shkronjës "b', të pikës 6, të këtij neni, mund të detyrojë Operatorin e Sistemit të Transmetimit të zbatojë një ose më shumë nga alternativat e mëposhtme:

a) të sigurojë financimin nga ndonjë palë e tretë;

b) të kërkojë ndërtimin nga ndonjë palë e tretë;

c) të administrojë asetet e reja pas ndërtimit.

Në këto raste tarifat përkatëse do të mbulojnë kostot e investimeve në fjalë.

8. ERE në ushtrimin e kompetencave të parashikuara në pikat 1, 6 dhe 7, të këtij neni, duhet të marrë mendimin nga ministri përgjegjës për energjinë.

Së fundmi në nenin 97 "Tregu i energjisë elektrike"

3. Ministri përgjegjës për energjinë, në bashkëpunim me palët e interesuara në sektorin e energjisë elektrike dhe pasi merr mendimin e Autoritetit të Konkurrencës, harton modelin e tregut të energjisë elektrike, që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, ku përcaktohen të paktën:

a) mënyrat e bashkëpunimit ndërmjet pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike;

b) marrëdhëniet kontraktore të nevojshme;

c) informacioni dhe shkëmbimi i të dhënave kryesore, të kërkuara mes pjesëmarrësve të tregut.

Fusha përkatëse e përgjegjësisë së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes është përcaktuar në vendimin nr. 835, datë 18.9.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes", të ndryshuar.

Për sa i përket rolit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në raport me OST sh.a. shpjegojmë si më poshtë:

Rezulton se Operatori i Sistemit të Transmetimit, OST sh.a. është e organizuar në formën e një shoqërie aksionare me kapital 100% shtetëror. Kjo në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", ku në nenin 53, është përcaktuar se:

- Operatori i Sistemit të Transmetimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit është personi juridik i licencuar për kryerjen e veprimtarisë së transmetimit të energjisë elektrike, i cili ka në pronësi sistemin e transmetimit dhe respekton parimin e pavarësisë, të përcaktuar në nenin 54 të këtij ligji.

3. Këshilli i Ministrave përcakton autoritetin publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, i cili duhet të jetë i pavarur nga aktivitetet e prodhimit apo furnizimit, në kuptim të nenit 54 të ligjit.

Në zbatim të pikës 3 të nenit 53 të këtij ligji, është miratuar VKM-ja nr. 317 datë 27.14.2016, "Për përcaktimin e Autoritetit Publik që përfaqëson Shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike", e cila ka përcaktuar si më poshtë:

1. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., është Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

2. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST), është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

3. Ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes emërojnë anëtarët e këshillave mbikëqyrës të shoqërive të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, duke zbatuar kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike".

- Po kështu, në nenin 1, të ligjit nr. 8/2016, "Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare"", të ndryshuar, është përcaktuar se:

"Ushtrimi i së drejtës së përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, përfshirë edhe të drejtën e emërimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrës, në shoqëritë elektroenergjetike, bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe në shoqëritë e gazit natyror bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror."

Pra, nga përcaktimet e përmendura këtu më lartë, rezulton se secila nga ministritë e përmendura duhet të kryejnë funksionin e pronarit të aksioneve në shoqëritë përkatëse. Përpara këtij ndryshimi, ishte Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ajo që ushtronte funksionin e pronarit të aksioneve (autoritetin publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve) në të tria shoqëritë.

Për më tepër, sqarojmë se organizimi i tërë veprimtarisë ekonomike në Shqipëri rregullohet nga ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar. Ky ligj përcakton dhe rregullon statusin e tregtarit, themelimin dhe administrimin e shoqërive tregtare, të drejtat dhe detyrimet e themeluesve, të ortakëve dhe aksionarëve, riorganizimin dhe likuidimin e shoqërive tregtare. Ky ligj është i detyrueshëm edhe për shoqëritë shtetërore.

OST sh.a. në këndvështrimin e organizimit juridik i është nënshtruar ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar. Pra më konkretisht, roli i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes si autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve në raport me OST sh.a. është ai i pronarit të 100% të aksioneve. Kjo ministri sillet ndaj shoqërisë OST sh.a. dhe ushtron ato të drejta dhe ka ato detyrime njëlloj si çdo pronar tjetër privat ndaj aksioneve që ka në një shoqëri aksionare që në Shqipëri është ndërtuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 9901, datë14.4.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

Pra, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes luan rolin e aksionarit të vetëm, duke marrë çdo vendim që ka në kompetencë Asambleja e Përgjithshme në një shoqëri aksionare sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtarë" të ndryshuar.

Këtë rol për Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. dhe Operatorin e Shpërndarjes së

Energjisë Elektrike sh.a., në bazë të nenit 1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 27.14.2016 "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike", e luan Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

Rezulton se tashmë Korporata Elektro-energjetike Shqiptare sh.a. dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., kanë kryer të gjitha procedurat për përmbushjen e këtij detyrimi, duke përmbushur në këtë mënyrë dhe detyrimin e pavarësisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit, nga aktivitetet e prodhimit apo furnizimit, në kuptim të nenit 54 të ligjit.

Për sa i përket Këshillit Mbikëqyrës, në nenin 135 "Të drejtat dhe detyrimet" të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, është përcaktuar se:

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

a) përcaktimin e politikave tregtare;

b) ndryshime të statutit;

c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit (sistemi me një nivel) dhe (në sistemin me dy nivele) të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës.

Në statutin e OST sh.a. (neni 13 Këshilli Mbikëqyrës), është përcaktuar se:

Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Pra Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes emëron anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a. Rezulton se Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike" në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të OST sh.a. dhe në zbatim të pikës 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 27.4.2016 "Për përcaktimin e autoritetit publik", në të cilën është përcaktuar se:

Ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, emërojnë anëtarët e këshillave mbikëqyrës të shoqërive të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, duke zbatuar kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike".

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ka miratuar me vendimin nr. 4911, datë 14.6.2016 "Për ndryshimin në Këshillin Mbikëqyrës" anëtarët e rinj të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a.

Po kështu, Ministria e Energjisë dhe Industrisë në cilësinë e pronarit për Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. në zbatim të pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 27.14.2016, "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike", ka miratuar me urdhrin nr. 210, datë 30.6.2016, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të KESH sh.a. dhe me urdhrin nr. 209, datë 30.6.2016, ka miratuar anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të OSHEE sh.a.

Për sa më sipër, konkludojmë se anëtarët e Këshillit e Mbikëqyrës të OST sh.a., janë emëruar nga MZHETTS, duke respektuar kufizimet e imponuara nga neni 54 i ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

- Në bazë të nenit 54, në pikat 3, 4, 5, 6 përcaktohet se:

3. Duke filluar nga data 1 janar 2016, i njëjti person nuk ka të drejtë që në të njëjtën kohë:

a) të ushtrojë kontroll, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbi një të licencuar, që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror dhe të ushtrojë kontroll ose ndonjë të drejtë tjetër ndaj Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose rrjetit të transmetimit;

b) të ushtrojë kontroll, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe të ushtrojë kontroll ose të ushtrojë ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror;

c) të emërojë anëtarët e këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht

Operatorin e Sistemit të Transmetimit apo rrjetin e transmetimit dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të ushtrojë kontroll apo ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror;

ç) të jetë anëtar i këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licencuarin pranë të licencuarve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit ose furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror dhe veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose rrjetit të transmetimit.

4. Ndalimet e parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të paragrafit me sipër do të zbatohen në mënyrë të veçantë për:

a) kompetencën për të ushtruar të drejtën e votës;

b) kompetencën për të emëruar anëtarët e këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë të licencuarin;

c) të drejtën e mbajtjes së një pjese të shumicës së aksioneve.

5. Detyrimi i parashikuar me sipër, konsiderohet se është përmbushur nëse dy ose më shumë shoqëri, të cilat kanë rrjetet e tyre të transmetimit, kanë krijuar një sipërmarrje të përbashkët, e cila vepron si një operator i sistemit të transmetimit në dy ose më shumë shtete. Asnjë shoqëri tjetër nuk mund të jetë pjesë e kësaj sipërmarrjeje të përbashkët, përveç rastit kur shoqëria është përcaktuar si operator i pavarur i sistemit të transmetimit dhe është certifikuar sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

6. Kur personi i përmendur në paragrafin më sipër, është një organ publik që kontrollohet nga shteti, atëherë dy organe të veçanta publike që ushtrojnë kontroll, njëri mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe tjetri mbi të licencuarin që kryen funksionin e prodhimit ose të furnizimit të energjisë elektrike, do të konsiderohen sikur nuk janë i njëjti person.

Siç evidentuar më lart në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 27.4.2016 "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike", rezulton se Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes është mbajtëse e 100 % të aksioneve të OST sh.a., ndërkohë që MEI është 100 % aksionare e KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., të cilat ushtrojnë përkatësisht aktivitetin e gjenerimit dhe shpërndarjes e furnizimit universal të energjisë elektrike.

Në këtë mënyrë, për qëllime të ndarjes së pronësisë së OST sh.a., rezulton e kryer kjo ndarje sipas parashikimeve të pikës 6, të nenit 54 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe në përputhje me sa përcaktuar në nenin 8, germa "a", të Rregullave për Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike, ku përcaktohet se, ndër kriteret që duhet të përmbushen nga aplikuesi për të mundësuar vendimmarrjen dhe certifikimin nga rregullatori është: a) Personi juridik që ka pronësinë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike nuk duhet të ketë të drejta kontrolli të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në aktivitetet e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit apo anasjelltas;

Në nenin 8, pika 2, germa "b" të rregullores përcaktohet se: Personi juridik që ka pronësinë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike nuk emëron, kontrollon apo është anëtar i bordeve apo strukturave drejtuese në aktivitetet e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit apo anasjelltas, si dhe nuk ushtron të drejtën e votës apo të drejtën e mazhorancës së aksioneve;

Kjo kërkesë e rregullores, ka gjetur zgjidhje në kuadër të parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 27.4.2016 "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike", shpjeguar në mënyrë të detajuar më lart.

Në germën "c" të pikës 2 të nenit 8 të "Rregullores për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike", kërkohet të garantohet konfidencialiteti i informacionit komercial që Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike zotëron dhe mos transferimi i stafit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike te ndërmarrjet /sipërmarrjet gjeneruese apo furnizuese;

Referuar akteve të brendshme të kompanisë (Kodi i Etikës i OST sh.a. nr. 3952 prot., datë 1.7.2016)

rezulton se çdo punonjës i OST sh.a. duhet të respektojë ndër të tjera ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit edhe pas largimit nga shoqëria. Në mënyrë të veçantë në nenin 14 të Kodit të Etikës është përcaktuar sa vijon:

Të mbrojnë sigurinë e çdo informacioni konfidencial, garantojnë mbrojtjen e informacionit që marrin dhe të mos e bëjnë atë publik pa autorizim përkatës por pa cenuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", mos përdorimi i informacionit të mbledhur për përfitim personal, të marrë masa e të parandalojë dhe të mbrojë rrjedhjen e informacionit, të mos përdorë marrjen dhe dhënien e informacionit për përfitime të ndryshme ose kur përbën shkak për lindjen e konfliktit të interesave gjatë marrëdhënieve të punës, të mos japin publikojnë apo të nxjerrin për përdorim publik materiale apo informacione që kanë të bëjnë me politikat ose me aktivitetet e OST sh.a. nëse nuk janë të autorizuar.

Po ashtu në referencë të nenit 64, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", OST sh.a. ka detyrimin e ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit të ndjeshëm tregtar. Në këtë nen përcaktohet se:

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit, duke respektuar në çdo rast përcaktimet e nenit 47 të këtij ligji, apo ndonjë detyrim tjetër ligjor për dhënien e informacionit, ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, të siguruar gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe parandalon përhapjen në mënyrë diskriminuese të informacionit për veprimtarinë e tij, me qëllim që të krijojë avantazh tregtar të një palë tjetër.

2. OST-ja nuk përhap të dhënat e ndjeshme tregtare të çdo të licencuari tjetër, përveçse kur kjo është e nevojshme për kryerjen e një transaksioni tregtar. Për të siguruar respektimin e plotë të rregullave të përhapjes së informacionit dhe ndarjes së veprimtarive, ERE merr masa që Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe çdo i licencuar tjetër të mos përdorin shërbime të përbashkëta, të tilla si shërbime të përbashkëta ligjore, përveç funksio-neve të thjeshta administrative apo të teknologjisë së informacionit.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit, gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij, nuk keqpërdor informacionin e ndjeshëm tregtar të siguruar nga palët e treta, në kuadër të ofrimit apo negocimit të aksesit në sistem.

4. Informacioni i nevojshëm që garanton konkurrencën dhe funksionimin normal të tregut bëhet publik.

Sa më sipër kërkuar nga ligji është pasqyruar në aktet e brendshme të OST sh.a., shpjeguar në mënyrë të detajuar në paragrafin më sipër.

- Në nenin 8, pika 2, germa "d", kërkohet: Pasja në dispozicion të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike të burimeve të nevojshme financiare, teknike, fizike dhe njerëzore për të realizuar aktivitetin e tij. Lidhur me këtë kriter të rregullores, në analizë të dokumentacionit të dorëzuar nga aplikuesi rezulton se:

Parlamenti Shqiptar, më 30 prill të vitit 2015 miratoi ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i cili shënon një hap shumë të rëndësishëm për gjithë legjislacionin shqiptar në përgjithësi si një dëshmi e përafrimit të tij me legjislacionin evropian, por ka rëndësi të veçantë për sektorin e energjisë elektrike, për sa i përket organizimit dhe funksionimit të tij. Ky ligj reflekton parashikimet e paketës së tretë legjislative evropiane në fushën e energjisë dhe si rrjedhojë vendos kritere të reja për organizimin dhe funksionimin e shoqërive të sektorit elektroenergjitik dhe tregut të energjisë elektrike. Një vend të veçantë në këto parashikime ligjore, zë Operatori i Sistemit të Transmetimit, sishoqëria e sektorit elektroenergjitik që ka detyrimin për të garantuar sigurinë e gjithë sistemit elektroenergjitik shqiptar. Për këtë, OST-ja duhet të sigurojë pavarësinë e saj nga kompanitë e tjera të sistemit elektroenergjitik nëpërmjet procesit të certifikimit, transparencës në procesin e alokimit të kapaciteteve të transmetimit, sigurimit të energjisë për humbjet dhe shërbimet ndihmëse në tregun e energjisë nëpërmjet procedurave konku-rruese dhe transparente, sigurimit të balancimit të sistemit nëpërmjet organizimit dhe operimit të tregut të disbalancave, sigurimit të tarifave transparente për aksesin në rrjetin e transmetimit, pjesëmarrje

aktive në organizimin dhe funksio-nimin e tregut të energjisë elektrike. Duket qartë që ligji i ri, ashtu sikurse edhe synimi për anëtarësimin me të drejta të plota në ENTSO-E, e vendos OST-në përballë shumë detyrimeve dhe si rrjedhojë para një perspektive të re, e cila kërkon përshtatjen e OST-së me një kompani evropiane transmetimi. Që do të thotë, zhvillimin e OST-së, jo vetëm si një kompani që përmbush të gjitha kriteret teknike dhe ligjore evropiane, por edhe si një tërësi burimesh njerëzore që e bëjnë të mundur përmbushjen e këtyre kritereve. Edhe struktura organizative e OST sh.a. është konceptuar duke pasur parasysh pikërisht gjithë sa më sipër, me disa drejtori që kryejnë funksione administrative me varësi nga administratori i shoqërisë dhe tri departamentet, që lidhen drejtpërdrejtë me përmbushjen e objektivave ligjore të sipërpërmendura dhe konkretisht:

- Drejtoria e Drejtimit Operativ, Drejtoria e Operatorit të Tregut, Drejtoria e Planifikim Zhvillimit dhe Drejtoria e Shfrytëzim Mirëmbajtje të Transmetimit u riorganizuan në formën e Departamenteve të cilat përfshijnë disa drejtori si më poshtë vijon:

- Departamenti i Operimit që përfshin 4 drejtori: Drejtoria e Planifikimit dhe Zbatimit të Kodit; Drejtoria e Drejtimit Operativ; Drejtoria e Shërbimeve Teknike; Drejtoria e Tregut të Energjisë Balancuese dhe Drejtoria e Humbjeve në Rrjet. Në këtë mënyrë sigurohet që funksionet e operimit të sistemit të përfshijnë edhe planifikimin e transmetimit (zyrë/sektor) që më parë ishte i përfshirë në Drejtorinë e Planifikim Zhvillimit, si një sektor i lidhur drejtpërdrejtë me të dhënat që sigurohen nga operimi i sistemit. Nga ana tjetër krijimi i një drejtorie të veçantë brenda Departamentit të Operimit i ngarkuar posaçërisht me sigurimin e energjisë për humbjet dhe shërbimet ndihmëse në tregun e energjisë nëpërmjet procedurave konkurruese dhe transparente dhe sigurimin e balancimit të sistemit nëpërmjet organizimit dhe operimit të tregut të disbalancave, konsiderohet si një domosdoshmëri e imponuar nga ligji i ri i sektorit të energjisë dhe një kusht i domosdoshëm për mirëfunksionimin e sektorit të energjisë elektrike, në mënyrë transparente dhe në shmangie të çdo diskriminimi.

- Departamenti i Operimit të Tregut, me dy drejtori në përbërje të tij, është konceptuar si një entitet që në një afat maksimal deri në datë 31.12.2017 do të ndahet ligjërisht dhe financiarisht nga OST-ja. Ky departament ashtu sikurse janë të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në ligj, do të jetë i ngarkuar me operimin e tregut të energjisë elektrike, me organizimin dhe administrimin e pasqyrave financiare të energjisë elektrike mes pjesëmarrësve të tregut; mbajtjen e llogarive në emër të palëve tregtare për transaksionet e shitblerjes së energjisë elektrike midis palëve, menaxhimin e procesit të regjistrimit të palëve në treg; menaxhimin e procesit të propozimit, miratimit dhe çdo amendimi të Rregullave të Tregut në përputhje me ligjin etj.

- Departamenti i Transmetimit, i cili përfshin Drejtorinë e Implementimit të Projekteve dhe Inxhinierisë dhe Drejtorinë e Shfrytëzim Mirëmbajtjes së Transmetimit. Ky Departament, përfshin dy drejtori:

- Drejtorinë e Implementimit të Projekteve dhe Inxhinierisë, e cila garanton implementimin optimal të projekteve të zhvillimit të rrjetit, të financuara nga komuniteti i donatorëve të huaj. Është përgjegjëse për projektimin, ndërtimin dhe modifikimin e objekteve e të Rrjetit të Transmetimit të OST (linjat, nënstacionet dhe objektet ndihmëse) në përputhje me planet e përcaktuara të investimeve dhe përforcimeve, duke i përshtatur ato me kërkesat e Planifikimit të sistemit dhe me specifikimet teknike, financiare dhe mjedisore të kompanisë. Përcakton politikën mjedisore të OST dhe siguron zbatimin e saj, me qëllim minimizimin e ndikimit në mjedis të aktiviteteve dhe objekteve të saj. Kryen veprimet ligjore për hartimin e dokumentacionit të nevojshëm për fillimin e procedurave të shpronësimit dhe regjistrimit të pasurive të paluajtshme të OST-së;

- Drejtorinë e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes së Transmetimit, e cila shfrytëzon dhe mirëmban linjat e transmetimit 400 kV, 220 kV 154 kV dhe 110 kV, e nënstacioneve lidhëse midis tyre dhe e nënstacioneve pranë burimeve prodhuese të energjisë elektrike me tension 220 kV e lartë. Shfrytëzon dhe mirëmban sistemin e telekomunikacionit në shërbim të OST sh.a. Shfrytëzon dhe mirëmban sistemin e matjes së energjisë elektrike, në objektet brenda OST sh.a. Mirëmban sistemin e mbrojtjes rele dhe sistemet e

kontroll-monitorimit të nënstacioneve të OST-së.

- Siç cituar më lart, OST është e organizuar në departamente dhe drejtori, si më poshtë vijon:

-Kabineti,

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve,
- Drejtoria e Prokurimeve,
- Drejtoria Ligjore,
- Departamenti i Operimit të Sistemit,
- Departamenti i Operimit të Tregut,
- Departamenti i Transmetimit.

Numri total i punonjësve është 725.

- Departamenti i Operimit të Sistemit, përfshin dispeçeritë.
- Departamenti i Transmetimit përfshin punonjësit që kanë për detyrë mirëmbajtjen e rrjetit të transmetimit.
- Të gjitha burimet financiare të OST-së përfshihen në buxhetin/programin ekonomik të vitit përkatës, i cili miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i OST-së, në përputhje me dispozitat e nenit 20/2/h të statutit të kompanisë (siç përmendet te shpjegimet për nenin 8, pika 2, germa "m" e këtij vendimi) dhe nga Asambleja e Përgjithshme (e cila nënkupton pronarin e OST-së, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) në përputhje me dispozitat e nenit 9.2/ç të statutit të kompanisë dhe ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe kompanitë tregtare", të ndryshuar, neni 135/2/a.
- OST disponon të gjitha mjetet teknologjike, software-et e nevojshme për të kryer aktivitetet e saj, siç përshkruhet më poshtë.

Përshkrim i përgjithshëm i sistemit

SCADA/EMS System

Sistemet SCADA (Mbikëqyrje kontroll dhe përvetësimi i të dhënave) janë një zgjidhje optimale për qendrat e kontrollit, pasi mundësojnë një operim të sigurt dhe eficient të sistemit elektroenergjitik. Këto sisteme kanë një përdorim të gjerë në të gjitha infrastrukturat energjetike (prodhim, transmetim dhe shpërndarje). Operatori i Sistemit të Transmetimit Shqiptar, OST sh.a. në qendrën e kontrollit operon me "*Net Work Manager SCADA/EMS* (*Supervisory Control and Data Acquisition/Energy Management System*)", projekt i cili është implementuar në nëntor të 2012-s. Përveç eficiencës në operimin e sistemit, menaxhuesi i rrjetit, është gjithashtu një sistem informacioni mbi energjinë, duke i mundësuar vendimmarrësve një proces informacioni të sigurt.

Menaxhuesi i rrjetit mundëson një ambient i cili inkurajon dhe përmirëson njohjen dhe studimin e sistemit elektroenergjetik, si dhe mjetet e sistemit të menaxhimit të energjisë (*EMS tools*), duke bërë të mundur që pjesëmarrësit të operojnë në mënyrën më optimale të mundshme. Kjo platformë e hapur dhe e gjithanshme lejon integrimin e sistemeve të tjera të informacionit dhe në të njëjtën kohë edhe një nivel të lartë të sigurisë së IT.

Aplikacionet e menaxhuesit të rrjetit, janë të ndërtuara mbi një platformë të hapur në një arkitekturë të vetme dhe mund të manovrohen për kontrollin dhe analizën në kohë reale, si dhe për qëllime optimizimi dhe planifikimi. Këto mjete të fuqishme për operimin e rrjetit mundësojnë një operim ditor në kohë reale dhe të sigurt duke minimizuar shpenzimet kapitale afatgjata.

1. SCADA (Mbikëqyrje kontroll dhe përvetësim i të dhënave)

Në sistemin e kontrollit SCADA të Operatorit të Sistemit të Transmetimit Shqiptar, OST sh.a. monitorohen dhe operohen në kohë reale të gjithë nënstacionet 400/220kV, si dhe nënstacionet më të rëndësishme 110 kV. Në lidhje me aplikacionet e sistemit SCADA mund të përmendim disa nga më të rëndësishmet:

- Funksionet e përvetësimit të të dhënave, të cilët mundësojnë integrimin e pajisjeve të kontrollit të sistemeve të fuqisë, RTU-ve, si dhe sistemet e kontrollit të nënstacioneve. Protokolli, i cili përdoret për

komunikimin me RTU-të, si dhe sistemet e kontrollit të nënstacioneve është: IEC 6087-5-104. Komunikimi me qendrat e tjera të kontrollit kryhet nëpërmjet ICCP (*Inter-Center Communication Protocol*). Aktualisht OST sh.a. përdor ICCP për komunikimin me CGES (Qendra e Kontrollit e Malit të Zi) dhe IPTO (Qendra e Kontrollit e Greqisë).

- Monitorimi dhe procesimi i eventeve;
- Kontrolli mbikëqyrës dhe ndërlidhës;
- Arkivimi i të dhënave;
- Raportimi dhe llogaritjet;
- Ndërveprimi njeri-makinë.

2. EMS Sistemi i Menaxhimit të Energjisë (*Energy Management System*).

Menaxhuesi i rrjetit EMS ofron një potencial të plotë të sistemit të menaxhimit të energjisë. Sistemi i menaxhimit të energjisë (EMS) përmbush objektivat për optimizimin e transmetimit të energjisë, kostot e operimit dhe në të njëjtën kohë ruajtjen e sigurisë së sistemit. Funksionet e tij përfshijnë:

- Përkrahje në vendimmarrje ne lidhje me menaxhim e rrjetit;
- Planifikim të energjisë;
- Kontroll dhe skedulim të gjenerimit;
- Monitorimin e rrjetit;
- Vlerësim të sigurisë;
- Përmirësim të operimit bazuar në skenarët e shpërndarjes optimale të flukseve të fuqisë;
- Mundëson parashikimin e ngarkesës.

Moduli i sistemit të menaxhimit të energjisë (EMS) është i përbërë nga disa aplikacione të rrjetit, ku secili nga këto aplikacione bashkëvepron me të tjerët, por menaxhohen në mënyrë të veçantë nga njeri-tjetri. Modulariteti i EMS-së ofron një lehtësim në menaxhimin e të gjithë paketës së tij. Aplikacionet e Rrjetit të cilat janë pjesë e EMS-së:

- Fotografuesi i telemetrisë (*SNP-Telemetry Snapshot*): Fotografuesi i telemetrisë është përgjegjës për marrjen e të dhënave te matjeve nga Lexuesi i Gjendjes dhe Lexuesi Analog (Status and Analog Retrieval) dhe aplikimet e tjera te rrjetit siç janë matjet dhe gjendja e çelësit (*measurements and breaker status*). Gjithashtu, është përgjegjës për përditësimin dhe ndryshimin e limiteve, duke bërë shpërndarjen e limiteve të vendosura manualisht ose atyre të llogaritura nga Skedari i vlerave të procesuara dhe matjeve në data bazë.- Marrësi i statusve dhe matjeve (*SAR-Status and Analog Retrieval*): Funksioni bazë i marrësit të statusit dhe matjeve është të mbledhë/koordinojë të dhënat nga ndërtuesi i modelit të rrjetit (NMB), vlerësuesi i gjendjes së sistemit (SE) dhe rrjedhën e dispeçerimit të energjisë elektrike, *Dispatcher Power Flow* (DPF).

- Ndërtuesi i Modelit të Rrjetit (*NMB-Network Model Builder*): Funksioni i ndërtuesit të modelit të rrjetit përcakton topologjinë aktuale të rrjetit (modeli *bus/branch*), duke pasur parasysh të dhënat për statuset aktuale të elementeve komutues (çelësat, thikat e linjave, thika e zbarave etj). NMB- ja, gjithashtu, identifikon rrjetet elektrike në sistemin elektroenergjetik. Topologjia përdoret edhe nga aplikacione të tjera.

- Vlerësuesi i gjendjes së sistemit (*SE-State Estimator*): Vlerësuesi i gjendjes së sistemit është komponenti më i rëndësishëm në lidhje me funksionimin e EMS-së dhe përdoret për të njehsuar dhe vlerësuar gjendjen e përgjithshme të sistemit elektroenergjetik.

- Analizuesi i Sigurisë (*SA-Security Analysis*): Analizuesi i sigurisë është aplikacioni i cili është përgjegjës për përcaktimin, përzgjedhjen, si dhe analizën e kontigjencave.

3. Sistemi i menaxhimit të gjenerimit (*Generation Management System-GMS*)

Sistemi i menaxhimit të gjenerimit (GMS) përmban procese, që në kohë reale rregullojnë gjenerimin e fuqisë në përputhje me detyrimet operuese dhe ekonomike, mban frekuencën e sistemit, si dhe shkëmbimin ndërkufitar në vlerat e tyre të skeduluara. Duke u nisur nga fakti që Shqipëria ka njësi gjeneruese hidrike, sistemi i kontrollit të gjenerimit mundëson në kohë reale kontrollin dhe menaxhimin e

fuqisë hidrike, si dhe të burimeve hidrike. Aktualisht të implementuar në sistemin e kontrollit të gjenerimit janë: HEC Fierza, HEC Koman dhe HEC Vau i Dejës.

Në qendrën e kontrollit të OST sh.a. është implementuar vetëm kontrolli automatik i gjenerimit (*AGC-Automatic Generation Control*). Kontrolli automatik i gjenerimit rregullon daljen e njësive gjeneruese në mënyrë që të mbajë frekuencën e sistemit, si dhe shkëmbimin ndërkufitar në vlerat e tyre të skeduluara në përputhje të plotë me standardet e publikuara nga ENTSO-E.

4. Aplikacione të tjera të menaxhuesit të rrjetit. Objektivat kryesore në operimin e sistemit të energjisë elektrike janë: siguria, kualiteti, besueshmëria dhe ekonomia. Për të përmbushur këto objektiva, si dhe standardet e ENTSOE, përveç këtyre tre komponentëve kryesorë të menaxhuesit të rrjetit (SCADA/EMS/GMS) janë zbatuar edhe aplikacione të tjera të cilat janë pjesë e këtyre komponentëve.

- ICCP(*Inter-CenterCommunication Protocol*): Shkëmbimi në kohë reale i të dhënave ndërmjet qendrave të kontrollit është bërë më i thjeshtë dhe eficent duke përdorur ICCP. ICCP mundëson një platformë dhe ambient të hapur, të cilat operojnë në mënyrë të pavarur ndërmjet qendrave të kontrollit. Komunikimi ndërmjet qendrave të kontrollit menaxhohet nëpërmjet pajisjeve të jashtme të cilat janë posaçërisht për këtë komunikim, si dhe sigurohet nga përdorimi i "firewall-it" (siç edhe kërkohet nga standardet e ENSTO-E).

- Heqja automatike e ngarkesës (*Load Shedding*): Funksioni i heqjes automatike të ngarkesës, mundëson aftësinë për të hequr dhe rivendosur ngarkesën nga një listë e paracaktuar ngarkesash.

- Parashikimi afatshkurtër i ngarkesës (*STLF- Short Term Load Forecast*): Funksioni i parashikimit afatshkurtër të ngarkesës (STLF) mundëson një parashikim me saktësi të lartë të ngarkesës, për një periudhë deri në 15 ditë përpara. STLF proceson në mënyrë të saktë modelet e ndryshme të cilat karakterizojnë ngarkesën e vendit (ditore, javore dhe sezonale) duke përfshirë edhe influencën e variabileve të motit. Saktësia në parashikim përmirësohet me kualitetin e të dhënave historike të ngarkesës dhe variabileve të motit të cilat përdoren për të ndërtuar parashikimin.

- Parashikimi i Kongjestioneve (*CF-Congestion Forecast*): Parashikimi i Kongjestioneve (CF) është një mjet për analizimin e kushteve të rrjetit në të ardhmen duke përfshirë llogaritjen e limiteve të korridoreve të transmetimit. CF është një sekuencë programesh të organizuara brenda NAC dhe të ekzekutuara automatikisht. Mjeti CF suporton një studim "një ditë më para" (24 orë e ardhshme).

Cilësitë më të mëdha të Menaxhuesit të Rrjetit të sistemit SCADA/EMS për operimin e sistemit të transmetimit, përfshijnë:

- Përdorimi optimal i Aseteve të Rrjetit të Transmetimit.

- Përmirësimin e sigurisë së rrjetit dhe monitorimin e vazhdueshëm të qëndrueshmërisë së sistemit, duke vënë në dukje kushtet e operimit të cilat mund të çojnë në "blackout" të gjerë.

- Vizualizimin e avancuar dhe identifikimin e situatave të ndryshme nga operatorët, gjë e cila çon në një përmirësim të operimit rrjetit.

- Kualitet të lartë të furnizimit.

Pamje e Përgjithshme e Sistemit të Menaxhimit të Tregut.Platforma Elektronike për Menaxhimin e Tregut të Operatorit të Sistemit të Transmetimit në Shqipëri OST sh.a.

Kjo platformë është e organizuar në tri grupe kryesore funksionale, të cilat janë të ndërlidhura me njëra tjetrën.

Funksioni i OST-së

- Llogaridhënia dhe vendosja;

- Skedulimi.

Platforma e transparencës,

Funksioni i Operimit të Tregut

Më poshtë janë të paraqitura të gjitha modulet dhe funksionet e tyre:

1.1 Procesi i llogaridhënies dhe vendosja

Ky proces duhet të përmbushë funksionet e mëposhtme të OST sh.a.:

- Merr automatikisht nga sistemi i matjes ose vendos manualisht matjet e linjës së transmetimit e cila lidh dy pjesë të një sistemi (*tieline)*;

- Realizohet shkëmbimi ndërkufitar i matjeve horizontalisht ndërmjet TSO-ve dhe informacionet e llogaridhënies dhe vendosjes midis niveleve të ndryshme hierarkike të ENTSO-e RGCE;

- Siguron një standard duke mundësuar një paraqitje uniforme për transmetimin e të dhënave të sakta, të dhënave të llogaridhënies dhe zgjidhjes midis Operatorëve Evropianë të Sistemit të Energjisë Elektrike dhe të gjitha organizatave përkatëse midis hierarkisë së ENTSO-E RGCE.

1.2 Procesi i skedulimit

Sistemi i skedulimit duhet të përmbushë të gjitha funksionet e skedulimit dhe raportimit të OST si Operator i Sistemit të Transmetimit (OST) në Shqipëri dhe Operatorit të Bllokut të Kontrollit (CBO) te blloku shqiptar (*AL Block*).

Sistemet e skedulimit duhet të mundësojnë funksionet e mëposhtme të OST-së:

- Renditja e proceseve sipas orareve te publikuara për hapjen e portave;
- Paraqitja e balancës për zonën e balancimit në vend;
- Paraqitja e balancës për palën përgjegjëse për balancimin në vend (BRP);
- Paraqitja e totalit të zonave të balancimit, zonave të kontrollit;
- Zbulimi dhe menaxhimi i problemeve dhe disbalancave (sigurimi i sinjaleve të perceptueshme dhe vizuale);
- Paraqitja e shkëmbimeve të energjisë midis zonave të balancimit;
- Menaxhimi i prodhimit dhe konsumit të deklaruar;
- Zbulimi nëse enti sipas rregullimit sekondar është jashtë radhës;
- Koordinimi i OST-së (paraqitja e deklarimeve ndërkufitare, deklarime vetë OST-së për import/eksportin);
- Paraqitja e skeduleve të pjesëmarrësve duke ngarkuar dosjet XML;
- Ndryshim i skeduleve të paraqitura;
- Importi i transmetimit të veçuar në nivel ditor nga veçuesit e kapacitetit të transmetimit;
- Importi i kontratave për të drejtat e kapacitetit në baza ditore duke ngarkuar dosjet XML;
- Importi dhe modifikimi kontratave për të drejtat e kapacitetit duke hyrë në kapacitetin e veçuar të transmetimit në nivel vjetor, mujor, javor dhe ditor, si dhe nivelin e përditshëm;
- Kontrolli nëse kontratat për të drejtat e kapacitetit janë tejkaluar;
- Kontrolli dhe download i (dosjeve XML) i skeduleve dhe raporteve (pranimi, anomalia dhe konfirmimi);
- Pasqyrim i ngjarjeve, mesazheve dhe logove;
- Paraqitja e informacioneve rreth disponueshmërisë së enteve;
- Shtyrja e mbylljes së portës;
- Krahasim i kapacitetit të veçuar të përditshëm me nominimin;
- Krahasimi i imbalancave të skedulimit të ri, me një program skedulimi të mëparshëm;
- Raportet statistikore;
- NTC orare;
- Përputhshmëria SO-SO;
- Transmetimi i CAX që do të ndikojë te blloku i kontrollit dhe veçuesit e kapacitetit të transmetimit;
- Dërgimi dhe pranimi i planit total;
- Prodhimi i dokumenteve të nevojshëm për procesin e raportimit;
- Llogaritja e rezervave terciare bazuar te skedulimi.

2. Platforma e transparencës

Bazuar në rregulloren (EU) nr. 5 43/2013, 14 qershor 2013 dhe publikimin e të dhënave për tregjet e energjisë elektrike, është bërë e detyrueshme për shtetet anëtare evropiane që sigurojnë të dhëna, paraqitja e të gjithë informacionit që lidhet me energjinë elektrike.

Kjo platformë përbëhet nga disa fusha kryesore, të tilla si:

- gjenerim,
- ngarkesa,
- transmetimi,
- menaxhimi i konxhestioneve,
- remontet,
- balancimi për publikimin përmes platformës së transparencës ENTSO-E.

Transparenca lidhur me informacionet e tregut të energjisë luan një rol thelbësor në zbatimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike, si dhe për krijimin e tregjeve efikase, likuide dhe konkurruese të shumicës. Gjithashtu, ka një rëndësi të lartë në krijimin e një ambienti të barabartë ndërmjet pjesëmarrësve të tregut, duke shmangur kështu abuzimin dhe duke mundësuar rritjen e sigurisë së furnizimit të energjisë.

Moduli i transparencës do t'i mundësojë OST-së funksionet e mëposhtme:

- Burimi i të dhënave: Burimet e veçanta të të dhënave, të cilat përmbajnë të dhëna që kërkohen nga Rregullorja e BE-së duhet të publikohen. Për disa të dhëna është përgjegjëse OST-ja, disa të dhëna janë nën përgjegjësinë e prodhuesit të energjisë elektrike ose Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, apo edhe SEE CAO, i cili publikon të dhëna në emër të OST-së.

- Integrimi i të dhënave: Moduli i cili nxjerr të dhënat e kërkuara nga burimi i të dhënave, transformon ato në një model specifik dhe i ruan ETP bazën e të dhënave për lidhjen e tyre.

- Procesi i skedulimit: Bën të mundur mbledhjen e të dhënave (siç janë të dhënat e matjes ose sistemi SCADA) dhe më tej i publikon ato në platformë në afatet e mirëpërcaktuara.

- Procesi i transformimit të të dhënave: Transformon të gjitha të dhënat në formate standarde XML, të përcaktuara paraprakisht nga ENTSO-e dhe pastaj publikimin e tyre te formati i transparencës duke përdorur protokollin MADES. (**dokumenti XML duhet të përputhet me standardet e ENTSO-e).

- MADES: MADES është kanali i komunikimit i përdorur për paraqitjen e të dhënave te nyja qendrore e TPC, si dhe për markën e njohurive për procesimin e të dhënave.

- Procesi i "Njohjes": Si rezultat i një formati të paraqitur "Njohja" do të merret për çdo të dhënë të dërguar, për të siguruar që dosja e dërguar është në proces, është marrë dhe nuk ka asnjë problem teknik (p.sh. sintakse) ose problem në aplikacion (p.sh. në rastin kur nuk arrin të identifikohet Zona Detyruese (Bidding Zone).

3. Funksionet e Operatorit të Tregut (3.1 Ndarja e kapaciteteve të internjeksionit) Ky modul menaxhon procesin e përgjithshëm të ndarjes (alokimit) të kapaciteteve transmetuese të interkoneksionit, duke përfshirë përcaktimin e kapaciteteve dhe aftësive fleksibile për t'u integruar me sisteme të alokimit të kapaciteteve me të cilat operojnë OST-të e vendeve fqinje, si dhe me platforma rajonale për ndarjen e kapaciteteve rajonale.

Në këtë kontekst, kapacitetet transmetuese janë në thelb opsione për përcjellje të energjisë. Një ofertues i suksesshëm ka të drejtën, të marrë kapacitetin e caktuar. Kapaciteti, është një grup i përbërë prej një ose disa blloqesh ku secili prej tyre konsiston në një kapacitet (MW) të disponueshëm për një periudhë kohore. Një ofertues i suksesshëm mund të vendosë për të përdorur qoftë të drejtën për të marrë por edhe për të hequr dorë nga kapaciteti i caktuar.

3.2 Njoftimi i kontratave

Ky modul mbledh dhe ruan të dhënat dhe informacionet që kanë të bëjnë me kontratat e konkluduara ndërmjet pjesëmarrësve të tregut, si në tregun bilateral ashtu edhe në tregun e centralizuar të energjisë. Ai do të shërbejë si depozitues i të gjithë informacionit që lidhet me të dhënat e kontratave. Të dhënat që do të përfshihen si nënbashkësi brenda depozitimit kryesor të të dhënave.

Moduli për njoftimin e kontratës duhet të mundësojë funksionet e mëposhtme të OST-së:

- Të mbajë të dhënat në lidhje me të gjitha kontratat e mbyllura;
- T'i lidhë me përbërësit e menaxhimit të të dhënave për energjinë;

- T'i lidhë me përbërësit e skedulimit dhe të nominimit;
- Të jetë nënbashkësi e komponentit për depozitimin e të dhënave.

3.3 Skedulimi dhe nominimi

Ky modul menaxhon procesin e nominimit të skedulit fizik.

Një nominim është një kërkesë për një furnizues për një sasi fizike të energjisë elektrike sipas kushteve të një kontrate të veçantë.

Skedulimi ndan nominimin në kohë sipas një programi skedulimi ditor.

Moduli i skedulimit dhe nominimit duhet të përmbushë funksionet e mëposhtme:

- Të sigurojë raportimin për vlerësimin e fizibilitetit fizik të të gjitha kontratave;
- Të sigurojë raportimin e miratimit teknik për të gjithë kontratat e mbyllura;
- Të sigurojë raportimin e verifikimit të nominimeve me pjesëtarët e tregut;

- Të prodhojë ofertat përfundimtare të pranuara;
- Të konsolidojë të gjithë nominimet e mundshme, të vlefshme, të verifikuara dhe të kontraktuara;
- Të skedulojë termat për çdo kontratë furnizimi për çdo orë/ interval I përcaktuar për përdoruesit për ditën në avancë;
- Të skedulojë intervalet e heqjes automatike të ngarkesës (*load shedding*) aty ku nuk përmbushet kërkesa;
- Të lidhet me një sistem rajonal për parashikimin e ditës në avancë, kur/nëse kjo është funksionale gjatë jetëgjatësisë së sistemit;
- Të ofrojë informacion skedulimi për drejtuesin e bllokut të kontrollit;
- Të lidhet me sistemin për parashikimin e kërkesës së SCADA (STLF-Parashikimi i Ngarkesës Afatshkurtër). Rezultatet nga STLF (parashikimi i ngarkesës afat shkurtër janë në formatin XML bazuar në një skemë të veçantë xsd dhe që mund të hiqen në nga formati xls).

3.4 Menaxhimi i të dhënave për energjinë

Ky është komponenti kryesor që mbledh, proceson, menaxhon dhe arkivon të gjitha të dhënat e nevojshme të energjisë për procesin e duhur financiar. Komponenti duhet të përfshijë një modul faturimi të përcaktuar dhe një modul publikues të përcaktuar.

Procesi i vendosjes duhet të ndërmerret në bazë ditore për ditën paraardhëse.

- Të dhënat e menaxhuara duhet të përfshihen në një nëntabelë brenda depozitimit të të dhënave kryesore.
- Moduli Menaxhimi i të Dhënave të Energjisë duhet të mundësojë funksionet e mëposhtme të OST-së:
- Të përcaktojë furnizimet e kontraktuara;
- Të përcaktojë furnizimet e disbalancuara;
- Të japë të dhëna që shërbejnë si bazë për hartimin e faturave;
- Të ndjek historikun e pagesave, duke përfshirë edhe përpunimin e një analize të këtij historiku;
- Të ruajë dhe arkivojë të dhënat e energjisë, aktuale dhe të shkuara;
- Të ruajë dhe arkivojë të dhënat e faturuara, aktuale dhe të shkuara;
- Të publikojë të dhënat aktuale të konsumit nga palët tregtare;

- Të lidhet me komponentët për njoftimin e kontratës;
- Të lidhet me komponentët për mekanizmin e balancimit.

3.5 Depozitimi i të dhënave/raportimi

Ky modul merr dhe formaton të gjitha të dhënat që do të përdoren për analizat, raportimet dhe publikimet. Nënbashkësitë specifike të të dhënave do të përfshijnë sa më poshtë:

a) të dhëna të parashikuara;

b) të dhëna të ankandit;

c) të dhëna bilaterale të kontratës;
d) të dhëna të palës tregtare;
e) të dhëna të kontratës;
f) të dhëna të skeduluara;
g) të dhëna të balancimit;
h) të dhëna të vendosjes dhe faturimit;
i) të dhëna të bllokut ndërlidhës.

Moduli i të dhëna depozituese/raportuese duhet të mundësojë funksionet e mëposhtme të OST-së:

- Të sigurojë një formë standarde, konsistente, të pastër dhe të integruar të të dhënave.
- Të sigurojë të dhëna me strukturë të përshtatshme që të bëjnë të mundur përmbajtjen e të gjitha raportimeve të ndryshme dhe kërkesave analizuese.
- Të sigurojë dhe të menaxhojë fjalorë të dhënash për mbështetjen e aksesit dhe semantikës.
- Të sigurojë mjetet për të mbajtur origjinën e të dhënave, konvertimin dhe ngarkimin e të dhënave.
- Të sigurojë mjetet për menaxhimin e metadatës (një grup të dhënash që përshkruan dhe jep informacione në lidhje me të dhëna të tjera).
- Të sigurojë mjetet për të mbështetur inteligjencën e biznesit (raportimit dhe radhitjen, panelin e kontrollit, procesin analizues online etj.).

3.6 Mekanizmi i balancimit

OST disponon Modulin e llogaritjes së çmimit të tregut të balancimit (BMPC), që është përgjegjës për funksionalitetin e nevojshëm të tregut të OST sh.a. për llogaritjen e skeduleve dhe çmimit.

Duhet të përmbushen kërkesat e mëposhtme:

- Ndërfaqja e pjesëmarrësve të tregut (MPI), përgjegjëse për funksionimin e nevojshëm për ndërfaqen e pjesëmarrësve të tregut
- Regjistrimi i pjesëmarrësve të tregut (MPR), përgjegjëse për funksionimin e regjistrimit të pjesëmarrësve të tregut.

Ky modul përllogarit skedulet optimale ekono-mike të dispeçerimit për balancimin, duke dhënë:

- Nominimet fizike;
- Ofertat e energjisë rritëse/zbritëse;
- Parashikimi i ngarkesës së sistemit.

Çmimet së bashku me skedulimet e modulit BMPC ruhen në bazën e të dhënave të tregut të OST-se dhe më pas do të publikohen për pjesëmarrësit e tregut. Këto skedula, së bashku me çmimet e ekuilibrit të tregut, do të vihen, gjithashtu, në dispozicion të sistemit të vendosjes.

Moduli i Mekanizmit të Balancimit duhet të përmbushë funksionet e mëposhtme të OST-së:

- Të përllogarisë disbalancat e energjisë aktive (në MW/MWh) ndërmjet livrimit të skeduluar dhe atij aktual, për kontratën e secilit furnizues, në bazë ditore.
- Llogaritja do të ndërmerret në kohë reale, për një ditë më parë.
- Për të aplikuar politikat e çmimeve kontraktuale të rëna dakord (p.sh. përshkallëzimi i çmimeve për një disbalancim pozitiv (blerja) dhe çmimet për një disbalacim negativ (furnizimi). Disbalancat e vendosura nga OST sh.a. duhet të hiqen para përcaktimit për të përdorur përshkallëzimin e çmimeve për disbalancat pozitive dhe çmimet për disbalancat negative.
- Të ofrojë ndërhyrje manuale te çmimet e disbalancave.
- Të transmetojë detyrimet për disbalancën e llogaritur te pjesëmarrësit e tregut.
- Të lidhet me komponentin e njoftimit të kontratës.
- T'i mundësojë modulit të Menaxhimit të të Dhënave të Energjisë, të dhënat që lidhen me kontratat dhe disbalancat.

3.7 Shërbime ndihmëse

Ky komponent menaxhon tregtimin në këtë mekanizëm, ku përfshihet procesi i llogaritjes. Shërbimet ndihmëse përfshijnë kontrollin e frekuencës, rregullimin e fuqisë aktive nëpërmjet rezervave primare, sekondare, terciare, si dhe rregullimin e energjisë reaktive.

Moduli i Shërbimeve Ndihmëse duhet të mundësojë funksionet e mëposhtme të OST-së:

- Të llogarisë shërbimet ndihmëse (në MW/MWh) të planifikuara dhe aktuale, në lidhje me çdo kontratë të furnizuesve, në kohë reale.

Llogaritja duhet të ndërmerret në kohë reale, për një ditë më parë.

- Të zbatojë politikat e çmimeve kontraktuale të rëna dakord.
- Të bëjë të mundur ndërhyrjen manuale të çmimeve të shërbimeve ndihmëse.
- Të transmetojë përgjegjësitë e llogaritura të shërbimeve ndihmëse për pjesëmarrësit e tregut.
- Të lidhet me komponentin e njoftimit të kontratës.
- T'i sigurojë komponentit të të dhënave të menaxhimit të energjisë, informacion lidhur me kontratat dhe shërbimet ndihmëse.
- *Softwer* për parashikim automatik të kongjestioneve një ditë në avancë për OST-të e Evropës Juglindore.

Financuar nga banka KfW, EKC dhe grupi DMS zhvilluan softuerin me zgjidhje automatike për DACF, për OST-të e Evropës Juglindore. Agjencia e ekzekutimit të projektit ishte OST Shqipëri, dhe OST-të e grupit CMMI (*Congestion Management and Market Integration*) monitoruan procesin e zhvillimit.

Funksionet kryesore të softwer-it përfshijnë:

- Përgatitja e modeleve individuale FO (për parashikimin) në bazë të modeleve të snapshoteve dhe të dhënave të planifikimit.
- Bashkimi dhe përshtatja e modeleve rajonale të rajonit SEE.
- Analizat e DACF bazuar në modelet e bashkuara.

PSS®E 33.1- Aparat Simulator i Sistemit të Energjisë Elektrike për Inxhinieri (PSS/E)

Aparati Simulatori i Sistemit të Energjisë Elektrike për Inxhinieri (PSS/E) është një mjet softuer i cili përdoret për rrjetet elektrike të transmetimit. Është një program i integruar, interaktiv për simulimin, analizimin, dhe për të optimizuar performancën e sistemit të energjisë elektrike dhe ofron karakteristika probabilistike dhe dinamikë të modelimit. Softueri ofron për planifikimin e transmetimit dhe inxhinierët, një mjet për përdorim në projektimin dhe funksionimin e rrjeteve të besueshme.

Funksionet kryesore të software janë:

- Zgjidhje të shpejtë dhe të besueshme për shpërndarjen e flukseve të energjisë elektrike për modele të rrjetit deri në 200,000 nyje.
- Analiza të shpejta dhe të qëndrueshme të kontigjencave, duke përfshirë veprimet automatike korrigjuese dhe modelimin e skemës së veprimit korrigjues.
- Mbështetje të plotë nyje-çelës për modelimin e detajuar të topologjisë së nënstacionit. Analiza të automatizuara PV/QV me grafikë gjenerimi.
- Program automatizimi i fuqishëm dhe përshtatje me të gjitha karakteristikat Python® API.
- Analiza të balancuara dhe të pabalancuara të lidhjeve të shkurtra, analiza të kontigjencave (deterministike dhe probabilistike).
- Rindërtim grafik të modeleve kontrolluese sipas përdoruesit.

Ndërfaqe grafike moderne.

Shpërndarje të plotë të flukseve të fuqisë dhe librari modelesh dinamike, duke përfshirë teknologjitë e reja si pajisjet FACTS dhe turbinat e erës.

- Model ndërtues (*Code-based, user-written*).
- Lehtësi në ndërtimin e grafikëve të objekteve të integruar.

Ndërtim grafik i modeleve (*user-defined*) kontrollues.

EAS (ENTSO-E- Sistemi i Ndërgjegjësimit *Awareness System*)

Sistem i centralizuar i cili menaxhohet nga dy entitete pritëse (*Amprion dhe RTE*) dhe ndahet me të gjitha OST-të partnere duke përdorur rrjetin e *Electronic Highway*. Kjo është një platformë informuese e cila u pasqyron OST-ve partnere një pamje globale dhe në kohë reale të Rrjetit Evropian të Transmetimit.

Gjithashtu, ka shumë raste ku përdorimi i kësaj platforme është shumë i dobishëm në punën e përditshme të dispeçerive, si për shembull në rastin e një disturbance, është e mundur që të identifikohet origjina dhe, gjithashtu, të jetë e dobishme në zgjidhjen e problemit. Përveç kësaj mund të përdoret në rastin kur arrihet një situatë kritike. Në këtë rast, na lejon që të përfitojmë një vlerësim më të mirë të kushteve dhe arsyeve që çuan në atë situatë.

Në këtë platformë, realizohet ndarja e të gjithë informacionit të kërkuar për sistemin tonë të transmetimit. Informacionet që ndahen janë dy tipa:

- Matjet dhe të dhënat automatike në kohë reale për një pasqyrim objektiv të fizikës.
- Treguesit manualë për analizën faktike dhe analizën për përllogaritjen e mundësive të ndryshme (*first step analysis):* gjendjet e sistemit, mesazhet e paracaktuara ose mesazhet me tekst të lirë.

Për sa përcaktuar në kriteret sipas 714/2009 e EC, lidhur me çështjet e *cross border* dhe si OST sh.a. i plotëson këto kritere.

OST është nënshkruese e marrëveshjes ITC.

OST sh.a. ndan të gjitha kapacitetet e ndërlidhura midis linjave të ndërlidhjes për të gjithë kufijtë, përmes ankandeve të organizuara nga SEE CAO. Përjashtimi i vetëm është kufiri Shqipëri-Kosovë, për faktin që Kosova akoma nuk njihet si zonë kontrolli (dhe Serbia nuk merr pjesë në SEE CAO).

Detyrimet për akses në rrjet përgatiten nga OST-ja dhe paraqiten për miratim tek autoriteti rregullator, sipas metodës së llogaritjes së tarifës për transmetimin e energjisë elektrike dhe sipas udhëzimeve për aplikimin dhe tarifave për lidhjet e reja ose modifikimin e lidhjeve ekzistuese në rrjetin e energjisë elektrikë të OST-së.

Tarifat e përmendura më sipër janë transparente, ato marrin në konsideratë nevojën për sigurinë e rrjetit dhe reflektimin e kostove reale të shkaktuara për aq kohë sa ato korrespondojnë me ato të një operatori eficient dhe strukturës së rrjetit, dhe aplikohen në mënyrë jodiskriminuese.

Në nenin 8, pika 2, germa "e", Angazhimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike për përmbushjen e një plani 10-vjeçar zhvillimor të rrjetit i monitoruar dhe aprovuar nga rregullatori;

Në lidhje me përmbushjen e këtij detyrimi, ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike», ka bërë disa parashikime të cilat përfshijnë dhe përbëjnë detyrimin e OST sh.a. në lidhje me hartimin e një plani 10-vjeçar zhvillimor, që duhet të përmbajë, procedurën e miratimit, procedurën e rishikimit, detyrimin e raportimit në lidhje me këto plane në ERE dhe më konkretisht:

Neni 60 i ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" - zhvillimi i rrjetit të transmetimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit harton një plan dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit, në konsultim me palët e interesuara, dhe e paraqet për miratim në ERE.
2. Plani i zhvillimit të rrjetit duhet të marrë në konsideratë:

a) kërkesën dhe ngarkesën ekzistuese dhe atë të parashikuar;

b) planifikimin urban dhe rajonal të zonës ku shtrihen instalimet e transmetimit;

c) planet e investimeve për rrjetet rajonale të Komunitetit të Energjisë;

ç) legjislacionin e mbrojtjes së mjedisit.

3. Plani i zhvillimit të rrjetit duhet të përmbajë:

a) masa efikase, në mënyrë që të garantojë përshtatshmërinë e sistemit dhe sigurinë e furnizimit;

b) mjetet financiare të parashikuara për investimet në sistemin e transmetimit;

c) të gjitha investimet e miratuara dhe të identifikojë investimet e reja, të cilat duhet të zbatohen në tri vitet e ardhshme;

ç) afate të përcaktuara për të gjitha projektet e investimeve;

d) informacion për pjesëmarrësit e tregut për infrastrukturën transmetuese kryesore që duhet të ndërtohet ose të përmirësohet gjatë dhjetë viteve të ardhshme.

4. ERE shqyrton planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit dhe në rast se vëren se nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, kërkon nga Operatori i Sistemit të Transmetimit të plotësojë dhe/ose të ndryshojë planin e tij dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit.

5. Operatori i Sistemit të Transmetimit paraqet pranë ERE-s, së bashku me aplikimin për miratimin e tarifës, planin e përditësuar të investimeve për vitin pasardhës. Në rast se Operatori i Sistemit të Transmetimit aplikon për një tarifë për një periudhë rregullatore më të madhe se 1 vit, programi i investimeve do të përmbajë një analizë të investimeve të planifikuara për periudhën rregullatore përkatëse.

6. Kur ERE konstaton se Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka realizuar për tri vite, një investim të parashikuar sipas planit 10-vjeçar, dhe gjykon se investimi është i nevojshëm dhe mund të financohet pa penguar operimin normal të rrjetit, i kërkon atij të marrë një nga këto masa:

a) të realizojë investimin në fjalë;

b) të organizojë një procedurë konkurruese për realizimin e investimit në fjalë, të hapur ndaj çdo investitori;

c) të pranojë rritjen e kapitalit, me qëllim financimin e investimeve të nevojshme.

7. Kur ERE merr masa, sipas shkronjës "b", të pikës 6, të këtij neni, mund të detyrojë Operatorin e Sistemit të Transmetimit të zbatojë një ose më shumë nga alternativat e mëposhtme:

a) të sigurojë financimin nga ndonjë palë e tretë;

b) të kërkojë ndërtimin nga ndonjë palë e tretë;

c) të administrojë asetet e reja pas ndërtimit. Në këto raste tarifat përkatëse do të mbulojnë kostot e investimeve në fjalë.

8. ERE në ushtrimin e kompetencave të parashikuara në pikat 1, 6 dhe 7, të këtij neni, duhet të marrë mendimin nga ministri përgjegjës për energjinë.

9. ERE harton dhe miraton një rregullore për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planeve të investimit.

Neni 56 - Detyrat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit Operatori i Sistemit të Transmetimit ka këto detyra kryesore: raporton çdo katër muaj në ERE, për:

ii) kërkesat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe të përdoruesve të sistemit për zhvillimin e rrjetit të transmetimit;

Po kështu ligji ka parashikuar (në nenin 60, pika 9) detyrimin e ERE-s për hartimin dhe miratimin e një rregullore për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planeve të investimit (aktualisht është në proces miratimi rregullorja e re), si dhe të drejtat e ERE-s kundrejt OST sh.a. në lidhje me planin.

Neni 20 - Të drejtat e ERE-s - ERE ka të drejtat e mëposhtme:

d) shqyrton dhe miraton në përputhje me parimin e planifikimit me koston më të ulët, planet e investimeve të operatorëve të transmetimit dhe shpërndarjes dhe monitoron zbatimin e tyre;

Për më tepër, struktura e re organizative dhe rregullorja e re e funksionimit të OST sh.a., ka reflektuar në mënyrë më të qartë dhe më të detajuar nëpërmjet ndarjeve të detyrave të secilës drejtori (shih përshkrimin e detyrave të Departamentit të Transmetimit) dhe angazhimin e OST sh.a. për përmbushjen e një plani zhvillimor.

Neni 8, pika 2, germa "f", i rregullores "Për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin nr. 154 datë 11.12.2015, të bordit të ERE-s**, Aftësia e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në rregulloren (EC) No. 714/2009 dhe ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike";**

Referuar dokumentacionit depozituar në ERE nga OST sh.a. rezulton se: OST sh.a. menaxhon linjat

e transmetimit me nivelet e tensionit duke filluar nga 110 kV në 400 kV, nënstacionet me nivelin më të lartë të tensionit 220 kV dhe 400 kV, si dhe instalime të tjera në përdorim për transmetimin e energjisë elektrike. Sistemi i transmetimit arrin 14 nënstacionet me një fuqi totale transformues të 3876 MVA. Dy nënstacionet kryesore 400/220 kV Tirana 2, respektivisht dhe Elbasan 2, që ka një kapacitet të instaluar prej 600 MVA secili, janë dy nyjat kryesore të sistemit të transmisionit për tranzit energjie nga rrjeti 400 kV (që vijnë nga linjat e interkoneksionit) në rrjetin 220 kV. Nyjat e ngarkesës së sistemit të transmetimit janë kryesisht nënstacionet 110 kV të sistemit të shpërndarjes dhe disa konsumatorë të lidhur direkt me rrjetin e transmetimit. Ka vetëm një 400/110 kV me kapacitet të instaluar prej 300 MVA. Linjat e transmetimit: Tërësia e linjave të sistemit të transmetimit përbëhet nga ato të tensioneve 110 kV, 150 kV, 220 kV dhe 400 kV. Gjatësitë e linjave të transmetimit, sipas niveleve të tensionit janë si më poshtë:

- Linjat e transmetimit 400 kV, 445 km (duke përfshirë edhe linjë të re Tirana 2 - Kosova b);
- Linjat e transmetimit 220 kV, 1145.5 km;
- Linjat e transmetimit 150 kV, 34.4 km;
- Linjat e transmetimit 110 kV 1418.0 km.

Një pjesë e linjave të transmetimit të përmendura më lart të përfshijë edhe linjat e interkonjeksionit me vendet fqinjë në territorin shqiptar si më poshtë:

- Linja e interkoneksionit 400 kV Zemblak (AL)
- Kardia (GR), 94.751 km;
- Linja e interkoneksionit 400 kV Tirana 2 (AL)
- Podgoricë (ME), 154.706 km;
- Linja e interkoneksionit 220 kV Fierzë(AL) -Prizren (KS), 68 km;
- Linja e interkoneksionit 220 kV Koplik (AL) -Podgoricë (ME), 37.765 km;
- Linja e interkoneksionit 150 kV Bistrica (AL) -Myortus (GR), 63.4 km;
- Linja e re e interkoneksionit 400 kV, Tirana 2 (AL) - Kosova b (KS), 242 km është përfunduar në qershor të vitit 2016, por nuk është në funksion. Burimet kryesore të prodhimit të energjisë elektrike me një kapacitet total prej 1475 MW janë të lidhur me rrjetin 220 kV, si dhe disa njësi të tjera të rëndësishme gjeneruese të cilat janë në proces, që do të jetë i lidhur me rrjetin 220 kV.

Rrjeti 400 kV është zhvilluar më vonë, sidomos për interkonjeksionin me sistemet fqinje. Ky është rrjeti kryesor përmes të cilit shkëmbimi i energjisë elektrike me vendet fqinje (në rajon) kryhet, ndërsa asnjë impiant prodhimi i energjisë elektrike kombëtare nuk është e lidhur me të. Fluksi i energjisë që vjen nëpërmjet linjave të interkonjeksionit 400 kV shkon për përdorues, kryesisht nëpërmjet dy shkallëve të transformimit: 400/220 kV dhe 220/110 kV.

OST sh.a. kryen menaxhimin e kapacitetit të kufizuar në përputhje me Rregulloren Menaxhimit të Kapacitetit të Kufizuar, miratuar nga ERE me vendimin nr. 124, datë 21.7.2016.

Impiantet e prodhimit të energjisë elektrike

Energjia elektrike në Shqipëri aktualisht prodhohet 100% nga hidrocentralet. Pjesa më e madhe e prodhimit vendas të energjisë elektrike kryhet nga kaskada e Drinit: HEC Fierzës, HEC Komanit dhe HEC Vau i Dejës, të cilat janë të lidhura me rrjetin 220 kV. Kjo kaskadë ka një kapacitet total të instaluar prej 1350 MW dhe arrin një mesatare prej rreth 77% të të gjithë prodhimit të energjisë elektrike. Pjesa tjetër i përket hidrocentraleve të vogla lidhur në rrjetin 110 kV dhe ata të lidhur në rrjetin e sistemit të shpërndarjes.

HEC-et me fuqi totale të instaluar prej 223 MW janë të lidhura në rrjetin 110 kV dhe hidrocentralit e vogla me një total të fuqisë së instaluar prej 181 MW janë të lidhura në rrjetin e shpërndarjes. Në këtë mënyrë fuqia totale e energjisë elektrike të injektuar në sistemin elektroenergjitikë në Shqipëri është rreth 1851 MW.

Neni 8, pika 2, germa "g", i rregullores "Për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin nr. 154 datë 11.12.2015, të Bordit të ERE-s, **Kompetencat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike për dhënien dhe menaxhimin e**

aksesit të palëve të treta, si dhe operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit me qëllim përmbushjen afatgjatë të kërkesës nëpërmjet planifikimit të investimeve, ndërtimin dhe komisionimin e infrastrukturës përfshirë dhe procedurën e autorizimit;

Në nenin 27 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të sigurojë lidhjen me rrjetin e transmetimit mbi kushte jodiskriminuese. ERE, në bashkëpunim me operatorët e rrjeteve, miraton rregullat që përcaktojnë kostot që do t'i ngarkohen përdoruesit në lidhje me kushtet e veçanta të pikës së lidhjes. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka të drejtë të refuzojë lidhjen në rrjet të një përdoruesi të rrjetit me arsyetimin e kufizimeve të mundshme në të ardhmen të kapaciteteve aktuale të rrjetit apo krijimit të një kufizimi të kapacitetit në pjesë të largëta të sistemit të transmetimit. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka të drejtë të refuzojë një pikë lidhjeje të re, bazuar në arsyetimin se do të krijojë kosto shtesë lidhur me nevojën e krijimit të kapaciteteve shtesë të elementeve të sistemit në zonën përreth pikës së lidhjes. ERE miraton rregulloren për procedurat për lidhjet e reja, të propozuara nga i licencuari, ku përfshihet edhe metodologjia e llogaritjes së kostove dhe marrëveshja standarde e lidhjes, të cilat janë transparente dhe eficiente për të siguruar lidhjen në mënyrë jodiskriminuese të çdo përdoruesi në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes. Këto rregulla dhe procedura specifikojnë edhe të drejtat dhe detyrimet e operatorit të rrjetit përkatës dhe të palës që kërkon lidhjen, në veçanti, kushtet për lidhjen, afatet, pikat e matjes, si dhe kufijtë e pronësisë midis sistemit dhe përdoruesit të sistemit. Aktualisht mënyra, formati i aplikimit dhe tarifat përkatëse, sipas te cilave paguhen lidhjet e reja, modifikimet ose rritja e kapacitetit të lidhjeve ekzistuese, në rrjetin elektrik të OST rregullohen nëpërmjet vendimit nr. 2, datë 10.1.2011 "Për miratimin e udhëzuesit për aplikimin dhe tarifat e lidhjes së re apo modifikimit të lidhjes ekzistuese në rrjetin elektrik të OST sh.a". Ky udhëzim do të jetë objekt i rishikimit në përputhje me përcaktimet e ligjin nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike".

Neni 8, pika 2, germa "h"të rregullores "Për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin nr. 154 datë 11.12.2015, të Bordit të ERE-s, **Mbështetjen dhe informacionin nga pronari i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike për përmbushjen e detyrave; financimin ose miratimin e financimeve të investimeve të miratuara nga rregullatori; mbulimin e detyrimeve për asetet e rrjetit; sigurimin e garancive për të lehtësuar/mundësuar financimin e zgjerimit të rrjetit**;

Në lidhje me këtë kriter të rregullores, rezulton se sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, neni 135, pika 2, germat "dh", "e", "ë", "f", "g":

Asambleja e përgjithshme e shoqërisë merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) shpërndarjen e fitimeve vjetore;

ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;

f) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;

g) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;

Në përputhje me parashikimet e Statutit të OST sh.a., neni 9, Asambleja e Përgjithshme (pra, pronari i OST sh.a.), merr çdo vendim që ka në kompetencë sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

Miratimet e mësipërme rezultojnë të jenë marrë sipas:

- Letër nr. 536/1 prot., datë 5.2.2016, e ministrit të MZHETTS-së "Miratim i programit ekonomik të shoqërisë për vitin 2016".

- Letër nr. 3104/1 prot., datë 28.4.2016, e ministrit të MZHETTS-së "Miratim i ndryshimeve në programin ekonomik të shoqërisë për vitin 2016".

- Letër nr. 6027/1 prot., datë 28.7.2016 e ministrit të MZHETTS-së "Miratim i bilancit kontabël dhe shpërndarjen e rezultatit të vitit 2015".

Siç është shpjeguar deri me tani, sipas nenit 8, pika 2, germa "h", rezulton që OST ka të gjithë mbështetjen e nevojshme nga pronari i saj, për të përmbushur detyrimet; financimin dhe miratimin e financimit të investimeve të miratuar nga rregullatori; mbulimin e përgjegjësive për asetet e rrjetit; duke siguruar garancitë për të lehtësuar /mundësuar financimin e shtimit të rrjetit;

- Shkresat zyrtare të përmendura më lart dhe në vijim janë dokumente që e vërtetojnë këtë mbështetje:

- Shkresa zyrtare me numër protokolli nr. 536/1, datë 5.2.2016, e (MZHETTS) "Mbi miratimin e programit ekonomik të kompanisë për vitin 2016", për Programin Ekonomik të Kompanisë për vitin 2016, ku planifikohen të gjitha shpenzimet dhe investimet që priten për kompaninë, bazuar në mjetet financiare.

Shkresa zyrtare me numër protokolli nr. 3104/1, datë 28.4.2016, e (MZHETTS) "Mbi miratimin e ndryshimeve të programit ekonomik të kompanisë për vitin 2016", ndryshimet e miratuara tashmë të programit ekonomik të kompanisë për vitin 2016 (nga shkresa më sipër me numër protokolli nr. 536/1, datë 5.2.2016). Ajo tregon se çdo ndryshim i programit ekonomik të miratuar, i transmetohet pronarit të OST sh.a. dhe paraqitet për miratimin e nevojshëm ligjor.

Shkresa zyrtare me numër protokolli nr. 6027/1, datë 28.7.2016, e (MZHETTS) "Për miratimin e bilancit financiar dhe shpërndarjes së rezultatit për vitin", për bilancin e kompanisë për vitin 2015.

Neni 8, pika 2, germa "i", i Rregullores "Për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin nr. 154 datë 11.12.2015, të Bordit të ERE-s, **Pasja e aseteve të nevojshme në pronësinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike, pajisjeve, stafit të punësuar, si dhe të një identiteti komercial të qartë dhe të dallueshëm nga operatorët e tjerë**;

Lidhur me këtë kërkesë të rregullores në përputhje me sa depozituar nga OST sh.a. në aplikimin për certifikim rezulton se OST sh.a. ka në pronësi të gjitha asetet listuar në mënyrë të detajuar në pikën 8.2.f), sipas bilancit të OST sh.a. dhe inventarit të aseteve të shoqërisë detajuar si më poshtë:

Për qëllime të dokumentimit të pronësisë së sistemit të transmetimit në pronësi (përfshirë ato në ndërtim) janë paraqitur dokumentet si më poshtë: Certifikatë pronësie me numrat përkatës të lëshuar nga ZRPP-ja respektive, sipas vendndodhjes së numrave të pasurive. Në analizë të këtij dokumentacioni mbi asetet e OST sh.a. dhe verifikimeve përkatëse të kryera mbi regjistrimin e tyre në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, rezulton se aplikuesi OST sh.a. ka kapacitetet e nevojshme për të ushtruar aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike.

Aplikuesi OST sh.a. ushtron veprimtarinë në kuadër të rregulloreve, udhëzuesit, manualet që lidhen me organizimin, operimin, aktivitetin apo nënkontraktimin e shërbimeve, akte këto, të cilat përfshijnë: a) statuti; b) rregullore e funksionimit të OST sh.a.; c) Kodi i Etikës; d) rregullore e lidhjeve të reja; e) Kodi i Transmetimit; f) Kodi i Matjes; g) rregullat e tregut; h) rregullat e ankandeve të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit SEE CAO versioni 1.3, miratuar me vendimin nr.135, datë 13.11.2015. Për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit në kufirin me Kosovën, OST sh.a, do të zbatojë vendimin nr. 140, datë 22.11.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s "Për miratimin e rregullores së alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit", i ndryshuar.

Rezulton se OST sh.a., KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., kanë logot dhe emërtimet të ndara dhe qartësisht të dallueshme nga njëra tjetra. Secila prej kompanive ka, gjithashtu, numrin unik të identifikimit (VAT number) në sistem.

Neni 8, pika 2, germa "j", organizimi sipas formave ligjore të përcaktuara nga neni 1 i Direktivës 68/151/EEC dhe kuadrit ligjor në fuqi;

Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, Operatori i Sistemit të Transmetimit (më poshtë referuar si OST sh.a), funksionon si shoqëri aksionare, regjistruar si person juridik me vendimin nr. 31935, datë 14.7.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Emri i kompanisë: "Operatorit i Sistemit të Transmetimit" sh.a. (OST), NIPT-i përkatës

K42101801N, me kapital 100% shtetëror me aksionar të vetëm Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Kapitali është 9.694.008.000,00 lekë, numri i aksioneve 9.694.008,00, vlera nominale 1 000.

Neni 8, pika 2, germa "k", Sistemet IT, godinat ku ushtrohet aktiviteti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike apo sistemeve të sigurisë dhe aksesit nuk mund të bashkëshfrytëzohen me ndërmarrje/sipërmarrje të prodhimit apo të furnizimit të integruara vertikalisht apo të kontraktojë të njëjtët ofrues të këtyre shërbimeve;

Lidhur me këtë kriter të rregullores, rezulton, ndërtimi i Qendrës së re Kombëtare Dispeçer dhe zyrave qendrore të OST sh.a., si dhe ngritja e një sistemi të ri SCADA/EMS me të gjithë funksionet e tij, i përfituar nga projekti i financuar nga Kooperacioni Italian, në vlerën 23 milionë euro, është padyshim dhe projekti më i rëndësishëm, kyç dhe vendimtar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit, në përputhje me parashikimet afatgjata të kërkesës për energji elektrike dhe me planet e zhvillimit të sektorit elektroenergjetik në tërësi. Qendra Kombëtare Dispeçer, e cila është përgjegjëse për operimin e rrjetit, përbën hallkën kryesore të Sistemit të Transmetimit, duke përfshirë edhe operimin e linjave të interkonjeksionit, sipas standardeve teknike të ENTSO-E. Gjithashtu, në vijim të sigurimit të operimit të vazhdueshëm dhe të sigurt të Rrjetit të Transmetimit sipas standardeve të ENTSO-E, në Qendrën Kombëtare Dispeçer, janë implementuar një sërë sistemesh automatike të cilat mundësojnë kontrollin e të gjithë Sistemit. Nëpërmjet këtyre sistemeve automatike mundësohet monitorimi në kohe reale i Rrjetit të Transmetimit dhe operimi i tij nga distanca. Të gjithë këto sisteme dhe funksione, kanë impakt të drejtpërdrejtë në infrastrukturën ku ata janë instaluar. Infrastruktura mundëson një ambient të sigurt për instalimin e sistemeve automatike, duke përmbushur kështu edhe standardet e një qendre dispeçer evropiane.

Godina e Qendrës së re Kombëtare Dispeçer dhe Zyrat Qendrore të OST-së, janë në pronësi të OST sh.a. sipas certifikatës për vërtetim pronësie lëshuar nga ZVRPP Tiranë, me numër 1168919. Selia qendrore e OST sh.a. rezulton: "Autostrada Tiranë – Durrës, km 9, Yrshek, Kashar, Tiranë, Shqipëri", sipas ekstraktit të thjeshtë të shoqërisë lëshuar nga QKR. Vetëm OST sh.a. ka të drejtën e disponimit mbi asetet pronë e OST sh.a., siç shpjeguar më lart.

Neni 8, pika 2, germa "l", Audituesi financiar i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike, nuk mund të jetë i njëjti subjekt që kryen auditimin e ndërmarrjeve/sipërmarrjeve gjeneruese apo të furnizimit të integruara vertikalisht;

Audituesi financiar i OST-së rezulton të jenë ekspertët kontabël : Sabina Shytaj, Sokol Toska,

Eneida Rrahmani, Remzi Sulo, Irena Pulo, emëruar me letër nr. 8775 prot datë 23.11.2015, të ministrit të MZHETTS.

Vërejmë së emërimi i audituesit financiar të OST sh.a. për vitin 2015, është bërë para hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 27.4.2016, "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike".

Rezulton se: Sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, neni 135, pika 2, germa "ç", dhe statutit të OST-së, neni 9, emërimi i audituesve financiarë të kompanisë është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 27.4.2016, "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike", Asambleja e Përgjithshme e OST sh.a. është MZHETTS dhe Asambleja e Përgjithshme e KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. është MEI.

Audituesit financiarë të KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e tyre, pra ministri i MEI.

Neni 8, pika 2, germa "m" Përbërja dhe kompetencat e Bordit Mbikëqyrës;

Në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar sipas pikës 9.1/l, Lista e anëtarëve të organeve kolegjiale të subjektit (bordit mbikëqyrës dhe/ose bordit drejtues) aplikues dhe të aktiviteteve të energjisë rezulton: Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a., sipas urdhrit të MZHETTS nr. 4911 datë

14.6.2016, "Për ndryshimin e Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a." janë përcaktuar anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

Në përputhje me parashikimet e nenit 20 të statutit të OST-së, Këshilli Mbikëqyrës i OST-së, ka këto kompetenca: Këshilli Mbikëqyrës emëron administratorin e shoqërisë.

Këshilli mbikëqyrës në cilësinë e organit mbikëqyrës, këqyr vënien në zbatim të Politikave tregtare të shoqërisë dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin. Ai ka në kompetencë:

a) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori;

b) të përgatisë, me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;

c) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;

d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;

e) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;

f) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës për t'iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit Mbikëqyrës për miratim, dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;

g) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël do të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur dhe raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, do t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe administratorit. Raporti i Këshillit Mbikëqyrës, përmendur në shkronjën "f" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;

h) të miratojë programin vjetor dhe ndryshimet e tij, si dhe veprimtarinë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë të paraqitur nga administratori;

i) të aprovojë hapjen e veprimtarive ose e njësive të reja (degë, përfaqësi etj. brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë) sipas legjislacionit në fuqi;

j) të përcaktojë shpërblimin e administratorit;

k) të miratojë krijimin e shoqërive të reja dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera, brenda kufijve të ligjit, sipas përcaktimeve të nenit 5, pika 5.1, të këtij statuti.

Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrolle që ai i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij. Brenda tre muajve nga data e mbylljes së vitit ushtrimor financiar, administratori duhet t'i paraqesë Këshillit Mbikëqyrës llogarite vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli.

Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5, të nenit 136, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Përtregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës duhet të thërrasë menjëherë Asamblenë e Përgjithshme, për të shqyrtuar nëse shoqëria duhet të prishet ose për marrjen e masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme.

Në nenin 23 të statutit janë përcaktuar edhe marrëveshjet që kërkojnë autorizim paraprak të Këshillit Mbikëqyrës të cilat janë:

- Të gjitha marrëveshjet që bëhen ndërmjet shoqërisë dhe administratorit apo ndonjë anëtari të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë;
- Marrëveshjet, me të cilat një nga personat e sipërpërmendur lidhet indirekt, apo në të cilat ai lidhet me shoqërinë nëpërmjet një personi ndërmjetës,
- Marrëveshjet që veprojnë ndërmjet shoqërisë dhe një subjekti tjetër ekonomik të një lloji të çfarëdoshëm, në rast se administratori apo një nga anëtarët Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë është pronar, ortak "i pakufizuar", administrator apo anëtar i drejtorisë së subjektit tjetër ekonomik.

- Marrëveshjet për marrjen dhe dhënien e huave afatmesme, afatgjata sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 8, pika 2, germa "n", Garantimi i pavarësisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike në vendimmarrje në lidhje me përmbushjen e detyrave të tij, si dhe në kompetencën për ngritjen e fondeve në tregun kapital nëpërmjet huamarrjes.

Lidhur me këtë kriter, në rregullore, për sa i përket garantimit të pavarësisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit, kompetenca për ngritjen e fondeve në tregun kapital nëpërmjet huamarrjes, lidhet drejtpërdrejtë me planin e investimeve për të cilën është folur në mënyrë të detajuar në sqarimet e nenit 8, pika 2, germa "e", më lart, i koordinuar edhe me politikat e përgjithshme të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike të Shqipërisë, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, i cili shërben si bazë për një proces huamarrjeje nga ana e OST sh.a. Procedura që ndiqet më tej për sa i përket vendimmarrjes nga organet e shoqërisë, mbështetet në parashikimet e bëra në statutin e shoqërisë dhe ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, siç është parashikimi i nenit 23, paragrafi i fundit i Statutit të OST sh.a., ku thuhet se për marrëveshjet për marrjen dhe dhënien e huave afatmesme dhe afatgjata sipas legjislacionit në fuqi, kërkojnë autorizim paraprak të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a.

Nuk përjashtohet mundësia që OST të përfitojë nga kreditë e marra nga institucionet ndërkombë-tare financiare, të kanalizuara nga organet qeveritare, në formën e marrëveshjeve të nënhuas, siç mund të jenë nga Ministria e Financave ose në formën e marrëveshjeve të huas të garantuara nga Ministria e Financave.

Neni 8, pika 2, germa "o", Pavarësia e mena-xhimit dhe stafit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike bazuar në kompetencat e Bordit Mbikëqyrës të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike në lidhje me rekrutimin, kompensimin dhe përfundimin e marrëdhënieve për drejtuesit ekzekutivë apo administratën pasi ka njoftuar rregullatorin mbi procedurat që rregullojnë çështjet e mësipërme dhe nëse ky i fundit nuk ka paraqitur objeksione;

Në përputhje me parashikimet e statutit të OST-së (neni 20, pika 1), Këshilli Mbikëqyrës i OST-së emëron administratorin e shoqërisë. Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 642, datë 11.10.2005 "Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore", udhëzimit nr. 318, datë 8.4.2009 "Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore", lidhet midis Këshillit Mbikëqyrës dhe administratorit, kontrata e administrimit të shoqërisë.

Aktualisht si rezultat i ndryshimit të bërë me ligjin nr. 8/2016, "Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, neni 1, në fund të fjalisë së parë, shtohet fjalia me këtë përmbajtje, në të cilën është parashikuar se: "Ushtrimi i së drejtës së përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, përfshirë edhe të drejtën e emërimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrës, në shoqëritë elektroenergjetike, bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe në shoqëritë e gazit natyror bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

Gjithashtu ka dalë urdhri i ministrit të MZHETTS nr. 4911, datë 14.6.2016 "Për ndryshimin e Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a, në bazë të të cilit nga Këshilli i ri Mbikëqyrës me vendimin nr. 17, datë 30.6.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a., "Për riemërimin e administratorit të OST sh.a." dhe vendimin nr. 18, datë 30.6.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a., "Për lidhjen e kontratës së administrimit të shoqërisë OST sh.a." është emëruar administratori dhe është lidhur kontrata e administrimit të shoqërisë.

Sipas kësaj kontrate, disa nga të drejtat dhe detyrat e administratorit, janë: merr përsipër që të realizojë objektivat që kanë të bëjnë vetëm me veprimtarinë e OST sh.a., të përcaktuara në aktet normative në fuqi, si dhe programet e zhvillimit ekonomik të OST sh.a. Për më tepër nuk duhet që gjatë periudhës që është administrator të jetë aksionar, agjent, konsulent apo i punësuar në shoqëri që kryejnë aktivitete të ngjashme me atë të OST sh.a. dhe të respektojë të gjitha kufizimet e tjera të parashikuara nga ligji nr.

43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike". Gjithashtu, nëpërmjet deklaratës së depozituar për procesin e certifikimit, është deklaruar nga administratori se është në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në nenin 54 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe neneve 8 dhe 9, të rregullores së miratuar me vendimin e ERE-s nr. 154, datë 11.12.2015 rregullat "Për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike" dhe në përputhje me to deklaron se, nuk merr pjesë në aktivitetet e shoqërive elektroenergjetike që kanë lidhje me prodhimin, shpërndarjen dhe ose/ose furnizimin me energji elektrike. Kjo deklaratë është plotësuar edhe nga punonjësit në nivel drejtorësh në shoqëri ku të gjithë kanë deklaruar se nuk marrin pjesë në aktivitetet e shoqërive elektroenergjetike që kanë lidhje me prodhimin, shpërndarjen dhe/ose furnizimin me energji elektrike.

Për sa i përket përfundimit të marrëdhënieve të punës, në kontratë janë parashikuar rrethanat e përfundimit të punës. Për sa u përket të gjithë punonjësve të shoqërisë OST sh.a. rezulton se marrja në punë, bëhet sipas kritereve të punësimit në OST sh.a., kritere këto të propozuara nga administratori i shoqërisë dhe të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i saj. Këto kritere rishikohen herë pas here dhe aktualisht janë në fuqi kriteret e miratuara me vendimin nr. 11, datë 06.05.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a., "Për miratimin e kritereve të punësimit në OST sh.a.". Në përfundim të procesit të përzgjedhjes, rregullimi i marrëdhënies së punës në OST sh.a. bëhet me kontratë individuale të punës. Kontrata tip e punës ka si bazë ligjore ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", kontratën kolektive në fuqi, të lidhur me sindikatën e cila ka shumicën e votave nga punonjësit, legjislacionin për sigurimet shoqërore, legjislacionin për tatimin mbi të ardhurat, aktet e funksionimit të shoqërisë ku hyjnë, rregullorja e funksionimit të shoqërisë, rregullat e punës dhe sigurimit teknik dhe Kodi i Etikës. Përcaktimi i pagave bëhet sipas strukturës së pagave dhe udhëzimit mbi aplikimin e tyre në OST sh.a., e propozuar nga administratori i shoqërisë dhe miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Aksionarëve të shoqërisë. Punëmarrësi duhet të kryejë në mënyrë të ndërgjegjshme, me cilësi dhe efektivitet, të gjitha detyrat që i jepen nga eprorët, të zhvillojë dhe mbrojë interesat e punëdhënësit dhe të shmangë gjithçka që mund t'i vërë ato në rrezik. Disa nga të drejtat dhe detyrat e punonjësve janë: Duhet të mbajë një disiplinë të lartë në punë në çdo drejtim, duhet të mbajë dhe të ruajë konfidencialitetin për çdo informacion mbi ose në lidhje me punëdhënësin, është plotësisht në dijeni dhe bie dakord që gjatë punësimit të tij duhet të mbajë parasysh dhe të zbatojë të gjitha standardet, politikat, procedurat dhe rregullat e funksionimit apo të brendshme që janë në fuqi apo mund të vendosen nga punëdhënësi kohë pas kohe etj.

Për sa i përket përfundimit të marrëdhënieve të punës në kontratën individuale tip, janë parashikuar rrethana dhe procedurat përkatëse në nenet 10 dhe 11, "Masat disiplinore dhe zgjidhja e kontratës". Këto procedura garantojnë që, për zgjidhjen e kontratës së punës, punëdhënësi respekton dhe zbaton të gjitha rregullat dhe procedurat e parashikuara në legjislacionin shqiptar të punës. Në kodin e etikës qartësisht janë të përcaktuara parimet e ushtrimit të detyrës nga punonjësi i OST sh.a. i cili përfshin ndër të tjera, detyrimin e punonjësit për të mbrojtur me besnikëri interesat e ligjshme të shoqërisë OST sh.a.; në kryerjen e detyrave duhet të jetë i ndershëm, efikas, duke pasur parasysh vetëm interesin e shoqërisë, respektimin e drejtuesve, punonjësve të tjerë, shëndetin dhe sigurinë në punë; të mos përfitojë në mënyrë të padrejtë nëpërmjet manipulimit, fshehjes dhe abuzimit të informacionit që ka, në dëm të një personi ose shoqërie tjetër; të mos kërkojë e as të mos pranojë, nga askush si shpërblim para ose sende me vlerë, për kryerjen e detyrave të tij; të ruajë konfidencialitetin e informacionit edhe pas largimit nga shoqëria, sipas përcaktimeve ligjore;

Po ashtu janë përcaktuar edhe rrethanat e konfliktit të interesit nga punonjësi i OST sh.a., veprimtarive të jashtme të punonjësit të OST sh.a., përdorimit dhe përhapjes së informacioneve konfidenciale.

Për sa i përket konfliktit të interesave të punonjësve në nenin 2 "Konflikti i interesit" të Kodit të Etikës së OST sh.a., është parashikuar se kush do të konsiderohet konflikt, cilat janë rastet dhe si do të trajtohen ato. Për më tepër :

- Konflikt të interesave do të konsiderohen ato raste kur interesi vetjak i punonjësit, ndërhyn në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në interesat e Shoqërisë.

Interesi vetjak i punonjësit përfshin çdo përparësi në lidhje me veten, familjen, të afërmit deri në shkallë të dytë, personat ose organizatat me të cilat punonjësi ka ose ka pasur marrëdhënie biznesi ose lidhje politike. Konflikti i interesit përfshin, gjithashtu, çdo lloj detyrimi financiar ose civil të punonjësit.

- Punonjësit e OST sh.a. duhet të njohin dhe zbatojnë me korrektësi detyrimet e kuadrit ligjor, që lidhen me parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrave të tyre.

- Për të shmangur konfliktin e interesit dhe rrezikun e përdorimit të gabuar të informacionit, është e nevojshme që punonjësit të këshillohen me drejtuesit e shoqërisë dhe autoritetin përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave të OST sh.a.

- Këto raste do të trajtohen sipas ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" (i ndryshuar); ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" (i ndryshuar), akteve nënligjore përkatëse dalë në zbatim të tyre, si dhe rregullores së brendshme të Shoqërisë.

Këto përcaktime janë parashikuar në nenin 2 "Konflikti i interesit" të Kodit të Etikës së OST sh.a.

Po kështu për sa u përket veprimtarive të jashtme të punonjësit të OST sh.a., në nenet 3 dhe 4, të Kodit të Etikës, është parashikuar se:

- Punonjësi nuk duhet të angazhohet në një veprimtari të jashtme që pengon në kryerjen e proceseve të tij të punës, përveçse në ato raste kur kjo është përcaktuar me marrëveshje të bashkëpunimit institucional dhe/ose në veprimtari të jashtme, që dëmton imazhin e shoqërisë.

- Punonjësi, për çdo rast të konstatuar në kundërshtim me sa më sipër, duhet të informojë Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve (DBNJSH).

- Veprimtaritë, në kuadër të veprimtarive sindikale ose të përfaqësimit të punëmarrësve ose veprimtaritë e mësimdhënies, janë të lejueshme kur ato nuk pengojnë në ushtrimin e detyrës.

Për më tepër, në nenin 14 të Kodit të Etikës është parashikuar përgjegjësia për përdorimin dhe përhapja e informacioneve konfidenciale si më poshtë:

1. Punonjësit kanë përgjegjësi:

a) Të mbrojnë sigurinë e çdo informacioni konfidencial, të OST sh.a.;

b) Të garantojnë mbrojtjen e informacionit që marrin dhe të mos e bëjnë atë publik pa autorizimin përkatës, por pa cenuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit";

c) Të ruajnë informacionin e mbledhur për shkak të detyrës funksionale apo detyrës së ngarkuar dhe mos ta përdorin atë për përfitim personal, në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e etikës;

d) Të marrin masa që të parandalojnë dhe të mbrojnë rrjedhjen e informacionit;

e) Të mos përdorin marrjen dhe dhënien e informacionit, për përfitime të ndryshme ose kur përbën shkak për lindjen e konfliktit të interesave gjatë marrëdhënieve të punës;

f) Të mos japin, publikojnë apo të nxjerrin për përdorim publik, materiale apo informacione që kanë të bëjnë me politikat ose me aktivitetet e OST sh.a., nëse nuk janë të autorizuar.

Neni 8, pika 2, germa "p", Përjashtimi i punonjëseve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike, nga e drejta e përfitimit financiar direkt apo indirekt nga shoqëritë e integruara vertikalisht;

Për sa i përket përfitimit financiar, direkt apo indirekt nga shoqëritë e integruara vertikalisht, deri në këtë moment, të vetmet parashikime janë ato të përcaktuara në kontratën tip të punës dhe Kodin Etik në OST sh.a. Për më tepër, ish-shoqëritë e integruara vertikalisht në sistemin energjetik shqiptar janë shoqëri shtetërore ku 100% e pronësisë është e shtetit, pra mundësia e përfitimit si rezultat i pronësisë, është zero. Po kështu edhe për sa i përket përfitimit prej mundësisë së punësimit edhe ajo është e pamundur në kushtet aktuale, edhe kjo si rezultat i faktit që janë shoqëri shtetërore, mënyra e organizimit të punës,

oraret e punës të cilat duke ju referuar përcaktimeve në Kodin e Punës, rrjedhimisht e bëjnë të pamundur dypunësimin e punonjësve.

Referuar ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", neni 3, përkufizime, aplikuesi nuk rezulton të jetë një kompani e organizuar vertikalisht. Specifikisht, "Shoqëri e integruar vertikalisht" është një shoqëri ose grup shoqërish të licencuara në sektorin e energjisë elektrike, ku i njëjti person ose persona, ushtrojnë kontroll mbi këto shoqëri në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhe ku shoqëria ose grupi i shoqërive, kryejnë të paktën një prej veprimtarive të transmetimit ose shpërndarjes, si dhe të paktën një prej veprimtarive të prodhimit ose furnizimit me energji elektrike, kërkesa e nenit 54/7 për ndarjen e pronësisë së OST-së është realizuar nëpërmjet VKM-së nr. 317, datë 27.4.2016, "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike".

Neni 8, pika 2, germa "q", Kompetencat vendimmarrëse të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike, për lidhjen e prodhuesve në sistem sipas procedurave të miratuara nga rregullatori.

Në bazë të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" neni 27, Operatori i sistemit të transmetimit duhet të sigurojë lidhjen në rrjetet e transmetimit mbi kushte jo diskriminuese në përputhje me rregullat e miratuara nga ERE. Aktualisht OST-ja siguron lidhjen në rrjet në përputhje me udhëzimin e miratuar nga ERE me vendimin nr. 2, datë 10.1.2011. Në këtë dokument, të miratuar nga ERE, janë përcaktuar mënyrat, formati i aplikimit dhe tarifat përkatëse, sipas të cilave paguhen lidhjet e reja, modifikimet ose rritja e kapacitetit të lidhjeve ekzistuese, në rrjetin elektrik të OST-së.

- Për efekt të këtij aplikimi nga OST sh.a., bashkë me kërkesën me shkrim për certifikim janë depozituar dokumentet e parashikuara në nenin 9 të "Rregullave për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit për energjinë elektrike", miratuar me vendimin e ERE-s, nr. 154, datë 11.12.2015.

- Rezulton se pjesa përbërëse e strukturës së OST sh.a., është Departamenti i Operatorit të Tregut që funksionon sipas rregullores së re të funksionimit të shoqërisë, miratuar me vendimin nr. 8, datë 30.3.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a., në pajtim me vendimin nr. 154, datë 11.12.2015 të Bordit të ERE-s "Për funksionimin e operatorit të tregut".

- Të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacioni i kërkuar sipas nenit 9 të rregullores, janë paraqitur në ERE në gjuhën shqipe dhe atë angleze, me shkrim dhe në mënyrë elektronike.

ERE ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, por mund të kërkojë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit çdo informacion të nevojshëm për qëllim të certifikimit, referuar pikës 4 të nenit 58, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

- Neni 9, i vendimit të Këshillit Ministerial nr. D/2011/02/MC-EnC, neni 58, pika 6, e ligjit 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", parashikon që ERE, duhet të vërë në dijeni Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë për vendimin e shprehur apo të pashprehur me fjalë për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit.

- Referuar kërkesës për certifikim, si dhe analizës dhe vlerësimit të dokumentacionit të depozituar për këtë qëllim nga OST sh.a., në ERE, në mbështetje të nenit 3, pika 8; nenit 16; neneve 54 dhe 58, pika 1, 3 dhe 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", vendimit të Këshillit Ministerial nr. D/2011/02/MC-EnC, Traktatit të Komunitetit të Energjisë, të ratifikuar me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, si dhe neneve 6, 7, 8, 9, pika 1, neneve 10 dhe 12, të rregullave "Për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike", miratuar me vendimin nr. 154, datë 11.12.2015, të Bordit të ERE-s, nenit 19, pika 1, germa "b", të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 15.7.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi aplikimin e OST sh.a., për certifikimin në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike, ka marrë vendimin nr. 117, datë 15.7.2016 dhe ka vendosur të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit për certifikimin në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike të OST sh.a.

- Në nenin 54, ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" ka përcaktuar se Operatori i

Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike, si prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë ligj. Shoqëria aplikuese, OST sh.a., në vijim të zbatimit të të gjitha kërkesave për ndarjen e aktivitetit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, ka paraqitur në ERE listën e dokumenteve, të dhënave dhe informacioneve që duhet të paraqiten nga një shoqëri elektroenergjetike, e cila aplikon për t'u caktuar dhe certifikuar si operator i transmetimit në Shqipëri. Për efekt të këtij aplikimi janë depozituar dokumentet si vijon:

a) Kërkesa me shkrim për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike;

b) Dokumentet, të dhënat dhe informacionet e përmendura në kapitullin III të rregullores; neni 9,

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s me Vendimin nr.160 date 6.10.2016 vendosi:

1. Miratimin paraprak të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC.

2. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për qëllime të implementimit të parashikimeve të nenit 8, pika 2, germat "c", "f" dhe "l", të "Rregullores për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit për energjinë elektrike", OST sh.a., të paraqesë në ERE dëshmi që tregon garancinë në lidhje me:

- pavarësinë e audituesit financiar të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike i cili nuk mund të jetë i njëjti subjekt që kryen auditimin e ndërmarrjeve/sipërmarrjeve gjeneruese apo të furnizimit të integruara vertikalisht.
- OST sh.a. t'i kërkojë Asamblesë së Përgjithshme (MZHETS) sigurimin e shmangies së emërimeve të audituesve financiarë të njëjtë me kompanitë e integruara vertikalisht.
- Mos-transferimi i stafit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike te ndërmarrjet/sipërmarrjet gjeneruese apo furnizuese;
- OST sh.a. të hartojë rregulla për përmbushjen e detyrimit, mbi ndarjen financiare dhe ligjore, siç parashikuar në nenin 57/2, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike".

- OST sh.a. të marrë masat paraprake dhe të bashkëpunojë brenda kompetencave të saj për realizimin e detyrimit ligjor të përcaktuar në ligj.

3. T'i përcjellë këtë vendim Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, për opinion, ashtu siç përcaktohet në nenin 58, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike".

4. T'i përcjellë këtë vendim Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Autoritetit të Konkurrencës.

Në datën 18 tetor 2016, ERE informoi Sekretariatin për vendimin paraprak mbi certifikimin e *Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a*, për energjinë elektrike .

Sipas nenit 10 të direktivës 2009/72/EC (këtu dhe më poshtë "Direktiva e Energjisë Elektrike") dhe nenit 3 të rregullores (EC) nr. 714/2009 (këtu dhe më poshtë "Rregullorja e Energjisë Elektrike") Sekretariatit i kërkohet të shqyrtojë Vendimin Paraprak të dërguar dhe të japë Opinionin e tij për përputhjen e këtij vendimi me nenin 10(2) dhe nenin 9 të Direktivës së Energjisë Elektrike.

Në datën 5 dhjetor 2016, bazuar në nenin 10(7) të direktivës së energjisë elektrike dhe nenit 3(3) të Rregullave të Energjisë Elektrike, Sekretariati i dërgoi ERE-s një kërkesë për të paraqitur dokumente shtesë të nevojshme për vlerësimin e përputhshmërisë së OST me kërkesat e ndarjes. Në datën 9 dhjetor 2016 ERE paraqiti dokumentet e kërkuara. Në datën 14 Dhjetor 2016 u mbajt një seancë dëgjimore në zyrat e Sekretariatit në Vjenë, ku morën pjesë të gjitha palët e interesuara.

Në datën 19 dhjetor 2016, Sekretariati u njoh me Opinionin për Vendimin Paraprak nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë siç kërkohet sipas nenit 3(1) të Rregullores së Energjisë Elektrike.

Në datën 24 janar 2017, Sekretariati bëri me dije ERE-n për Opinionin për Vendimin Paraprak të Certifikimit të OST sh.a. Më poshtë gjenden gjetjet dhe rekomandimet e Sekretariatit në opinionin e saj.

GJETJET DHE REKOMANDIMET E SEKRETARIATIT

Në këtë Opinionin Sekretariati ka theksuar se në vlerësimin e përputhshmërisë së vendimit paraprak të certifikimit me modelin e ndarjes sipas përcaktimeve në Direktivën e Energjisë Elektrike, rëndësi marrin aspektet e mëposhtme:

Aplikuesi që të certifikohet duhet të jetë pronar i aseteve transmetuese (neni 9 (1) a e Direktivës se Energjisë Elektrike.)

Aplikuesi që të certifikohet, duhet të jenë të ndara nga kontrolli mbi dhe ushtrimi i të drejtave në ndërmarrjet e përfshira në prodhimin ose furnizimin e energjisë elektrike dhe gazit natyror (neni 9 (1) –(3), (6), (7) dhe (12) e Direktivës së Energjisë Elektrike).

Lidhur me këto kritere në Opinionin e tij, Sekretariati konsideron se:

Në lidhje me germën "a', Sekretariati nuk ka asnjë arsye për të dyshuar se OST është në fakt pronari i sistemit të transmetimit.

Në lidhje me germën "b", bazuar në përvojën e saj të gjatë dhe bashkëpunim me OST, Sekretariati pajtohet gjithashtu me gjetjet e ERE-s që OST plotëson kriterin për ushtrimin e detyrave themelore si operator i sistemit të transmetimit.

Në lidhje me germën "c", Sekretariati pajtohet me ERE se Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Energjisë, që përfaqësojnë aksionet e shtetit në OST sha.a. dhe KESH/OSHEE respektivisht në përputhje me vendimin nr. 317, në parim kualifikohen si organe publike në kuptim të nenit 9 (6) të Direktivës se Energjisë Elektrike.

Kështu, Sekretariati pajtohet me gjetjet e ERE-s se, në përgjithësi, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Energjisë kanë kompetencat dhe mjetet e nevojshme për të ushtruar kontroll mbi OST dhe KESH / OSHEE përkatësisht. Të dy ministritë janë të pavarur në kuptimin e emërimit të anëtarëve të organeve drejtuese të kompanive të tyre përkatëse siç kërkohet nga neni 9 (1) (c) të Direktivës Energjisë Elektrike.

Gjithashtu, Sekretariati pajtohet me vendimin paraprak të ERE-s lidhur me audituesit financiarë të OST të cilët nuk mund të jenë të njëjtë me audituesit që kryejnë auditimit të ndërmarrjeve në prodhimin dhe furnizimin me energji elektrike.

Megjithatë, Sekretariati i ka parashtruar ERE-s, detyrimin për elaborimin dhe monitorimin e mëtejshëm të disa çështjeve, si dhe e ka orientuar ERE-n që të vendosë disa kërkesa shtesë për çështjen e licencimit, si më poshtë vijon.

A – Sekretariati kërkon që ERE, ne vendimin final të saj për certifikimin e OST, të elaborojë dhe të monitorojë këto çështje:

1. Sekretariati fton ERE-n për të monitoruar pajtueshmërinë me rregullat e ndarjes ligjore dhe funksionale të Operatorit të Tregut dhe përfshirjen e OST-së në të ardhmen në Bursën/tregun e energjisë.

Lidhur me këtë kërkesë të Sekretariatit, bordi i ERE-s konsideron se pavarësia ligjore dhe funksionale e Operatorit të Tregut, dhe Sigurimi i respektimit të gjithë kuadrit ligjor në fuqi për këtë qëllim, është i parashikuar në ligjin nr. 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*". Konkretisht, referuar nenit 3 paragrafi 51 i këtij ligji: "*Operatori i tregut*" është struktura përgjegjëse e licencuar për operimin, organizimin dhe menaxhimin e tregut të energjisë elektrike.

Më tej, neni 3 paragrafi 60, përcakton se "*Pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike*" është një entitet juridik, i regjistruar si pjesëtar i tregut të energjisë elektrike, që përfshin prodhuesit, tregtarët, furnizuesit, klientët, Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, sistemet e mbyllura të shpërndarjes dhe Operatori i tregut. Operatori i Sistemit Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes janë pjesëmarrës të tregut të energjisë elektrike vetëm për qëllime të sigurimit të energjisë elektrike të nevojshme për mbulimin e humbjeve në Rrjet, balancimit dhe Shërbimet ndihmëse.

Po kështu, në nenin 57 të këtij ligji, i quajtur "*Operimi i tregut*", përcaktohet se: "*1. Operimi i tregut të energjisë elektrike kryhet nga operatori i tregut, i licencuar nga ERE. Operatori i tregut është struktura përgjegjëse për menaxhimin e tregut të energjisë elektrike dhe përgatitjen e pasqyrave financiare për shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella të skemave për pjesëmarrësit e tregut, pa përfshirë blerjen apo shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me parashikimet e Rregullave të tregut.*

2. Operatori i tregut funksionon në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike dhe parashikimet e këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos, brenda datës 31/12/2017, për ndarjen ligjërisht dhe financiarisht të Operatorit të Tregut nga Operatori i Sistemit të Transmetimit".

Pra, nga analiza e këtyre dispozitave rezulton se operatori i tregut është konsideruar si një strukturë e pavarur dhe e licencuar më vete për të kryer aktivitetin e operimit të tregut, pikërisht për të siguruar transparencë dhe për të evituar ndërvarësinë nga pjesëmarrës të tjerë të Tregut. Në këtë kuadër, Operatori i Sistemit të Transmetimit është evidentuar si një prej pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, i cili ashtu sikurse pjesëmarrësit e tjerë, merr pjesë në tregun e energjisë elektrike vetëm për qëllim të sigurimit të energjisë elektrike të nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet, balancimin dhe shërbimet ndihmëse.

Nga ana tjetër, funksionimi i tregut të energjisë që menaxhohet nga Operatori i Tregut është parashikuar se do të kryhet në përputhje me rregullat e tregut. Rregullat e Tregut në përputhje me nenin 19/"a" te ligjit nr. 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", miratohen nga ERE, proces ky gjatë të cilit, siç parashikohet edhe në nenin 98/1, ERE bashkëpunon me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike (megjithëse propozo-hen nga OST).

Për më tej, ashtu sikurse parashikohet në nenin 54 të ligjit por edhe në parashikimet e direktivës 2009/72/EC, ndarja dhe pavarësia e OST-së, me qëllim certifikimin e OST-së, kupton ushtrimin e veprimtarisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit i ndarë nga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike si prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me Energji elektrike. Ndërkohë që përfshirja e OST-së në ndonjë strukturë të mundshme të Bursës Shqiptare të Energjisë, është një praktikë europiane e mirënjohur për përfshirjen e operatorëve të transmetimit në bursën e energjisë, që nuk bie në kundërshtim aspak me legjislacionin europian dhe atë vendas që traspozon këtë të fundit, e cila i shërben në fakt sigurimit të bashkëpunimit sa më efikas midis bursës se energjisë/tregut dhe operimit të sistemit.

Për më tepër, Sekretariati në lidhje me të tilla çështje është shprehur se: "*Me kusht që të sigurohet ndarja ligjore dhe funksionale, nuk përbën problem nëse OST ka në pronësi Operatorin e Tregut ose merr pjesë dhe zotëron aksione në bursën e energjisë për sa kohë që një kompani e tillë vetëm lehtëson tregtinë dhe ajo vetë nuk është e angazhuar në blerjen ose shitjen e energjisë*". Në këtë kuadër, Sekretariati vëren se ERE i ka kërkuar OST-së në vendimin paraprak hartimin e rregullave të nevojshme për këtë ndarje.

Gjithashtu, në këtë Opinion Sekretariati ngarkon ERE-n për të bërë certifikimin e OST, duke kushtëzuar transferimin e plotë të detyrave që lidhen me OST, tek aksionari i saj i vetëm – pra tek Ministria e Ekonomisë. Sekretari vlerëson se një proces i tillë do të kërkonte ndryshime të legjislacionit primar dhe sekondar, dhe një kohë të arsyeshme kalimtare mund të jepet.

Lidhur me këtë opinion të Sekretariatit, vërehet se, aktualisht kompetencat e Ministrit të Energjisë dhe Industrisë rregullohen në bazë të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" siç është specifikisht e shpjeguar edhe në paragrafët më lart në këtë vendim. Nga ana tjetër, duke qenë se Shqipëria ka ratifikuar Traktatin e Krijimit të Komunitetit të Energjisë dhe është palë kontraktuese e detyruar të ndërmarrë të gjitha hapat për të siguruar përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ky Traktat, është e tepër e rëndësishme marrja e masave për rregullimet e nevojshme në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë sektorin e energjisë elektrike në përputhje me direktivën 72/2009 të Parlamentit Europian.

Duke marrë në konsideratë faktin se qëllimi kryesor i procesit të Traktatit të Komunitetit të Energjisë është përgatitja e sektorit të energjisë të këtij rajoni për t'u integruar në tregun energjetik të BE-s nëpërmjet adoptimit dhe zbatimit të *acquis communautaire* në fushën e energjisë, si dhe duke konsideruar vendimin e Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë të datës 06.10.2011 në Chinsinau, Moldavi, sipas të cilit duke filluar prej 1 janar 2015 Paketa e Tretë e Energjisë do të jetë detyruese për të gjithë Palët Kontrakuese të Komunitetit të Energjisë, ERE vlerëson nevojën e ndryshimeve në legjislacionin vendas mbi bazën e paketës së tretë legjislative të BE në fushën e energjisë (Direktiva 2009/72/EC).

2. Sekretariati i ka kërkuar ERE që të verifikojë miratimin nga ministritë përgjegjëse, të programeve ekonomike për shoqëritë KESh sh.a., OSHEE sha. dhe OST sh.a. për vitin 2017.

Lidhur me këtë shqetësim, në vijim të vendimit paraprak të certifikimit dhe Opinionit të Sekretariatit, ERE konstaton se plani financiar i OST për vitin 2017 është miratuar nga aksionari i vetëm i saj, Ministria e Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes, referuar shkresës nr. 9801/1, datë 21.12.2016.

Sa i takon KESH sh.a dhe OSHEE sh.a., referuar komunikimit të datës 07.03.2017 të KESH sh.a me shkresën nr.578/1 prot, rezulton se më datë 02.02.2017 Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka miratuar Programin Ekonomik Financiar të KESh sh.a., për vitet 2017-2021. Gjithashtu referuar komunikimit të datës 07.03.2017 të OSHEE sh.a., është bërë me dije se më datë 03.03.2017 është miratuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë Programi Financiar i shoqërisë OSHEE sh.a. për vitin 2017.

Nga sa më sipër, ERE konstaton se për vitin 2017 është realizuar miratimi i programeve ekonomiko–financiar nga ministritë respektive që kanë përgjegjësinë për kompanitë OSHEE sh.a, KESH sh.a dhe OST sh.a.

3. Sekretariati vlerëson se Vendimi Përfundimtar i ERE-s duhet të analizojë më tej mbi rolin e Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose Presidentit. Kjo analizë sipas rekomandimit të Sekretariatit, duhet të marrë parasysh jo vetëm ligjin, por edhe realitetin kushtetues.

Në lidhje me këtë shqetësim të Sekretariatit, ERE shtjellon se përsa i takon rolit të Këshillit të Ministrave dhe të Kryeministrit në raport me Ministrinë e Ekonomisë dhe Energjetikës si dhe marrëdhëniet e Kryeministrit me Ministritë, këto elementë janë përcaktuar në ligjin nr. 90/2012, "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*", i cili rregullon organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave. Ky ligj përcakton kriteret për krijimin dhe funksionimin e institucioneve shtetërore.

Në nenin 4 të këtij ligji, të titulluar "*Organet dhe institucionet e administratës shtetërore*", përcaktohet se:

"*1. Kryeministri dhe ministrat janë organet e larta të administratës shtetërore. Ata drejtojnë dhe mbikëqyrin administratën shtetërore brenda fushës përkatëse të veprimtarisë shtetërore.*

2. Administrata shtetërore përbëhet nga këto institucione:

a) Kryeministria;

b) ministritë;

c) institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave;

ç) njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve;

d) agjencitë autonome;

dh) administrata e prefektit.

3. Ministritë dhe institucionet e varësisë mund të kenë degë territoriale në përputhje me këtë ligj".

Ndërkohë që përgjegjësitë e Kryeministrit janë të përcaktuara në nenin 102 të Kushtetutës. Konkretisht, neni 102 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcakton se Kryeministri ka këto përgjegjësi:

"*a. Përfaqëson Këshillin e Ministrave dhe kryeson mbledhjet e tij;*

b. Koncepton dhe paraqet drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për to;

c. Siguron zbatimin e legjislacionit dhe të politikave të miratuara nga Këshilli i Ministrave;

d. koordinon dhe kontrollon punën e anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe të institucioneve të tjera të administratës qendrore të shtetit;

e. Kryen detyra të tjera të parashikuara në Kushtetutë e në ligje.

2. Kryeministri zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet ministrave.

3. Kryeministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra.

*4. Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij, veprimet për të cilat ai ka kompetenca. Ministri, në ushtrimin e kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzim*e".

Sipas dispozitave të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*", të përmendura më lart, nuk vërehet asnjë boshllëk ligjor në rolin e Kryeministrit që do t'i lejonte atij për të ndikuar në autoritetin e ministrive të tjerë.

Nga ana tjetër, marrëdhëniet midis Ministrive dhe Këshillit të Ministrave përcaktohen në nenin 5 të Ligjit nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*". Ky nen përcakton se:

"*1. Çdo ministri drejtohet dhe përfaqësohet nga ministri, në vazhdim "ministri përgjegjës". Ministri është përgjegjës përpara Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit për tërësinë e veprimtarisë së ministrisë, institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome, më poshtë "sistem ministror", brenda fushës përkatëse të veprimtarisë shtetërore.*

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, përcakton fushën e veprimtarisë shtetërore në përgjegjësinë e çdo ministrie, në vazhdim "fusha e përgjegjësisë shtetërore".

3. Ministria kryen të gjitha funksionet administrative brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë shtetërore, përveç atyre që u delegohen shprehimisht institucioneve të varësisë apo u ngarkohen me ligj agjencive autonome.

4. Ministria është, gjithashtu, përgjegjëse për koordinimin dhe, në bazë të delegimit të ministrit, për mbikëqyrjen e veprimtarisë së institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë ministrore.

5. Organizimi i ministrisë përfshin aparatin e ministrisë, si dhe degët e saj territoriale, nëse është rasti".

Siç shihet nga këto dispozita, Ministri është përgjegjës përpara Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit për aktivitetin e ministrisë, institucionet nën administrimin e tij dhe agjencitë autonome brenda zonës përkatëse të veprimtarisë shtetërore.

Ndërkohë, sa i takon fushës së përgjegjësisë së Ministrit, është Këshilli i Ministrave, i cili me propozimin e Kryeministrit përcakton fushën e veprimtarisë shtetërore nën përgjegjësinë e çdo ministrie, ose siç quhet ndryshe "*fusha e përgjegjësisë shtetërore*". Në këtë mënyrë, çdo Ministri kryen të gjitha funksionet administrative në fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore, përveç atyre që u delegohen shprehimisht institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë ministrore.

Nga gjithçka u përmend më lart, konkludohet se çdo Ministri kryen funksionet administrative në fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore.

Ndërkohë, për sa i takon rolit të Këshillit të Ministrave në lidhje me OST sh.a., po i referohemi dispozitave të mëposhtme të Ligjit nr. 43/2015, "*Për sektorin e energjisë elektrike*".

Fillimisht, referuar nenit 4 të këtij ligji, ku përcaktohet se: "*Këshilli i Ministrave është përgjegjës për politikën e përgjithshme të zhvillimit të sektorit të energjisë së Shqipërisë në përputhje me politikat e zhvillimit ekonomik dhe sektorëve të tjerë të vendit. Këshilli i Ministrave miraton Strategjinë e Energjisë Kombëtare për Shqipërinë e cila hartohet nga ministria përgjegjëse për energjinë*".

Sipas nenit 6 të këtij ligji, "*Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit Përgjegjës të Energjisë, në bashkëpunim me institucionet ose entet e tjera që veprojnë në sektorin e energjisë, miraton rregullat për sigurimin e energjisë elektrike e furnizimit*". Gjithashtu, sipas nenit 31 të këtij ligji, "*Linjat e reja të interkonjeksionit të ndërtuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit apo investitorët privatë, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë. Gjithashtu Këshilli i Ministrave miraton kriteret dhe procedurat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e linjave direkte*".

Ndërkohe, sipas nenit 34 të këtij ligji përcaktohet se: "*Rregullat teknike për projektimin, ndërtimin dhe operimin e impianteve të prodhimit të energjisë elektrike, sistemin e transmetimit, sistemin e shpërndarjes, linjave të interkonjeksionit ose linjave direkte në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë rregullat e sigurimit teknik, hartohen nga ministria përgjegjëse për energjinë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardeve dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave*". Sipas nenit 97 te ligjit përcaktohet se: "*Ministri përgjegjës për energjinë në bashkëpunim me aktorë të tjerë në sektorin e energjisë elektrike dhe pas mendimit të dhënë nga Autoriteti i Konkurrencës, do të zhvillojë një modeli të Tregut të Energjisë Elektrike, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave*".

Me tej, nëse i referohemi nenit 53, konstatojmë se: "*Këshilli i Ministrave cakton autoritetin publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, i cili duhet të jetë i pavarur nga çdo*

aktivitet i prodhimit apo të furnizimit në bazë të dispozitave të nenit 54".

Gjithashtu në nenin 1 të ligjit nr. 8/2016 "Për një shtesë dhe një ndryshim në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995, "*Për transformimin e kompanive shtetërore*"", të ndryshuar, përcaktohen shprehimisht se:

"*Ushtrimi i së drejtës së përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, përfshirë edhe të drejtën e emërimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrës, në shoqëritë elektro-energjetike, bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe në shoqëritë e gazit natyror bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror."*".

Pra, nga të gjitha dispozitat që janë parashtruar më sipër, vërehet që secila nga ministritë e përmendura, do të kryejë funksionin e pronarit të aksioneve në kompanitë përkatëse.

Siç e theksuam më lart, është Këshilli i Ministrave i cili me propozimin e Kryeministrit, përcakton zonën e veprimtarisë shtetërore nën përgjegjësinë e çdo ministrie, pra "zonën e administratës shtetërore". Ndërkohë që Ministria kryen funksionet administrative në fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore, me përjashtim të atyre të deleguara për institucionet vartëse, ose që janë të ngarkuar me ligj për agjencitë autonome. Nga ana tjetër, raporti i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes, dhe Ministrisë së Financave, duhet të trajtohet nën përgjegjësinë e "administrimit shtetëror", që i është dhënë organeve përkatëse administrative.

Në këtë mënyrë, ERE konsideron se ndalimi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes për të ndërhyrë për operimin e përditshëm të OST është i rregulluar në bazë të ligjit nr. 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*". Në këtë ligj janë përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e OST-së. Shpjegimi për këtë çështje është dhënë në faqet 6, 35, të vendimit paraprak të certifikimit dhe të këtij vendimi.

Në bazë të nenit 55 dhe 56, të ligjit nr.43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", të drejtat dhe përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit janë përcaktuar në mënyrë të qartë dhe si të tilla të gjitha operacionet e OST do të bëhen nën kufizimin e këtij ligji. Gjejmë me vend të ritheksojmë se, neni 53 i këtij ligji përcakton se, Operatori i Sistemit të Transmisionit do të jetë një person juridik i licencuar për të kryer veprimtarinë e vepron si një sistem i transmetimit të energjisë elektrike, i cili zotëron sistemin e transmetimit dhe që respekton kriteret e pavarësisë sipas nenit 54 të këtij ligji.

Po kështu vlen të përmendet se, roli i Këshillit të Ministrave për sa i përket planeve të investimeve të OST sh.a., është i kufizuar në kompetencën e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të miratimit të linjave të reja të interkonjeksionit. ERE në miratimin e zhvillimin të planit dhjetë vjeçar do të marrë në konsideratë vendimin e mundshëm të Këshillit të Ministrave në lidhje me këtë çështje.

Lidhur me rekomandimin e Sekretariatit për shtjellime të mëtejshme për shkallën e autonomisë ligjore dhe funksionale të ministrave nga Kryeministri, Këshilli i Ministrave apo Presidenti, jemi të mendimit se, për efekt të vlerësimit të autonomisë ligjore dhe funksionale të Ministrit, mund të konsiderohen aspektet praktike që kanë të bëjnë me procedurën e emërimit dhe të shkarkimit të një ministri, si dhe me anë të një analize të vendimmarrjeve të një ministri.

Për qëllime të kësaj analize të mëtejshme, është marrë në konsideratë dokumentacioni ligjor i mëposhtëm:

i) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (më tej "Kushtetuta");

ii) Ligji nr. 90/2012, datë 27.09.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administrata e shtetit" (më tej "Ligji për administratën shtetërore");

(iii) Ligji nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshilli i Ministrave"(më tej "Ligji i Këshillit të Ministrave");

(iv) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 833, datë 18.09.2013 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë", të ndryshuar (më tej "VKM 833");

(v) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 835, datë 18.09.2013 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Ndërmarrësi", i ndryshuar

(tani e tutje "VKM 835"); si edhe

(vi) Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë.

Sa i takon procedurës dhe mënyrës se si Ministri emërohet në detyrë dhe procedurën përmes së cilës ai lirohet nga detyra vërehet se: neni 98 i Kushtetutës parashikon se një ministër, "*emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit, brenda 7 ditëve. Dekreti shqyrtohet nga Kuvendi brenda 10 ditëve*".

Kjo dispozitë përcakton qartë se, në procesin e emërimit dhe shkarkimit të ministrit do të marrin pjesë tre trupa vendimmarrëse – a) Kryeministri, b) Presidenti i Republikës dhe c) Kuvendi. Në mënyrë të veçantë, vërehet se ministri "*emërohet dhe shkarkohet*" nga Presidenti i Republikës, por propozimi duhet të vijë nga Kryeministri, i cili mund në çdo kohë të ndërmarrë nisma për emërimin si dhe shkarkimin e një Ministri. Megjithatë, duhet theksuar se Kuvendi luan një rol të rëndësishëm në këtë proces, për shkak se "dekretet" e Presidentit duhet të shqyrtohen nga Kuvendi brenda 10 ditëve.

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, me vendimin e saj nr. 6, datë 2002/01/18 ka analizuar dhe ka shprehur mendimin e saj pikërisht në lidhje me konceptin për procesin e "rishikimit" që i takon Kuvendit. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese deklaroi se:" *me fjalën shqyrtim*", në bazë të nenit 98 paragrafi 2 të Kushtetutës, është kuptuar drejtë dhe është detyrë e Kuvendit për të diskutuar dhe debatuar dekretin e Presidentit, dhe për të marrë një vendim në lidhje me miratimin e tij ose mosmiratimin e tij. Rishikimi i dekretit të Presidentit të Republikës, të lëshuar në përputhje me paragrafin 2, të nenit 98, të Kushtetutës, nuk është i kufizuar në një rishikim formal, por në një shqyrtim thelbësor.

Kjo do të thotë se, në një Republikë Parlamentare, është Kuvendi që në fund të fundit vendos me votë për emërimin ose shkarkimin e ministrit. Për më tepër, në këtë vendim Gjykata Kushtetuese ka analizuar natyrën e dekretit të Presidentit të Republikës në lidhje me emërimin ose shkarkimin e ministrit, efektin ligjor dhe kushtet e nevojshme për hyrjen në fuqi apo revokimin e saj. Nga kjo analizë, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se dekreti presidencial, "*si një akt individual i lëshuar nga organi kompetent, hyn në fuqi ose shfuqizohet pasi Kuvendi merr vendim për miratimin e tij ose mosmiratimit në fund të procesit të shqyrtimit*".

Kështu, edhe pse Kryeministri ka iniciativën për të emëruar ose për të shkarkuar një ministër dhe e bën propozim të tillë për Presidentin, është Presidenti i cili vlerëson një propozim të tillë, ndërsa efekti ligjor i dekretit si i tillë fillon vetëm pas shqyrtimit të Kuvendit të shprehur nëpërmjet votës së tij.

Prandaj, vërehet se, në praktikë ekzistojnë kufizime në pushtetin diskrecional të Kryeministrit për të emëruar apo për të shkarkuar një ministër. Nisma e Kryeministrit nuk është e mjaftueshme, pasi Kushtetuta kërkon nxjerrjen e një dekreti nga Presidenti dhe votimin në favor të tij nga Kuvendi.

Megjithatë, një vështrim i historisë politike të demokracisë në Shqipëri, tregon se situatat e "*bllokimit kushtetues*" mund të ndodhë shumë rrallë. Edhe në ato raste kur emërimi është propozuar nga një Kryeministër që i përket një partie politike që është e kundërt me partinë e Presidentit, Presidenti i Republikës nuk ka refuzuar deri më tani të miratojë propozimet e tij. Në anën tjetër, në mënyrë që propozimi i Kryeministrit dhe Dekreti presidencial për emërimin apo shkarkimin, të refuzohet në Kuvend, duhet të gjendemi në kushtet e konfliktit me vullnetin e mazhorancës qeverisëse dhe Kuvendit.

Por, duke pasur parasysh se Kryeministri emërohet nga shumica qeverisëse, një situatë e tillë në praktikë është shumë e rrallë, dhe mund të shfaqet në rastet kur shkarkimi prek një ministër të veçantë që gëzon një mbështetje të gjerë në Kuvend, ose një ministër që i takon një partie në koalicionin qeverisës, pa votat e të cilit dekreti i shkarkimit të saj nuk mund të aprovohen.

Në historinë post-komuniste të Shqipërisë, një rast i ngjashëm ka ndodhur vetëm në vitin 2002. Në në atë kohë, për shkak të konflikteve brenda mazhorancës, Kuvendi ka tejkaluar afatin kohor prej10 ditësh, të përcaktuar nga Kushtetuta, duke refuzuar të shqyrtojë për një kohë të gjatë dekretet presidenciale të emërimit të disa ministrave të rinj. Ndërsa kjo krizë politike priste të zgjidhej politikisht, vendi u qeveris për disa muaj rresht nga zëvendësministrat përkatës.

Megjithatë, për të vlerësuar shkallën e autonomisë së një ministri, përveç procedurës dhe mënyrës së emërimit dhe shkarkimit të Ministrit, janë analizuar edhe kompetencat e Ministrit dhe autoriteti i tij

vendimmarrës.

Siç dihet, është Kushtetuta e Shqipërisë që përcakton përgjegjësitë e Këshillit të Ministrave dhe Kryeministrit. Neni 100 i Kushtetutës thotë se "*Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore*". Për më tepër, Neni 95, paragrafi 2 parashikon për Këshillin e Ministrave një vendimmarrje të gjerë dhe diskrecionale autoriteti. Kështu, Kushtetua përcakton se: "*Këshilli i Ministrave ushtron çdo funksion shtetëror, i cili nuk u është dhënë organet e tjera të pushtetit shtetëror ose të qeverisjes vendore*".

Në të njëjtën kohë, Këshilli i Ministrave është organ kolegjial i cili përfaqësohet dhe kryesohet nga Kryeministri, i cili, sipas paragrafit 1 të nenit 102 të Kushtetutës,

"*Koncepton dhe paraqet drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për ato; siguron zbatimin e legjislacionit dhe të politikave të miratuara nga Këshilli i ministrat; bashkërendon dhe kontrollon punën e anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe institucionet e tjera të administratës qendrore të shtetit*". Për më tepër, Kryeministri ka autoritetin për të "*zgjidhur mosmarrëveshjet ndërmjet ministrave*".

Roli i ministrit është përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 102 të Kushtetutës duke qenë kështu i mirë përcaktuar në lidhje me rolin e Këshillit të Ministrave dhe Kryeministrit. Sipas kësaj dispozite, "*Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë. Ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime*". Pra, siç mund të shihet nga dispozitat e mësipërme, Kushtetuta ka vendosur Këshillin e Ministrave në pozicionin më të lartë ekzekutiv. Megjithatë, është gjithashtu e qartë dhe e padiskutueshme se Kryeministri ka një rol qendror ekzekutiv, i cili ushtrohet edhe nëpërmjet formulimit të politikave të qeverisë që janë objekt i miratimit në Këshillin e Ministrave.

Megjithatë përveç sa është përcaktuar në Kushtetutë, në funksion të vlerësimit të pavarësisë së vendimmarrjeve të një ministri, kjo pavarësi duhet analizuar edhe në kuadër të fushës së përgjegjësisë së Ministrisë që ai drejton.

Kështu, Neni 4 i ligjit për Administratën Shtetërore, përcakton se "*Kryeministri dhe ministrat janë organet më të larta të administratës shtetërore. Ata drejtojnë dhe mbikëqyrin administratën shtetërore brenda fushës përkatëse të veprimtarisë shtetërore*". Ndërkohë që Neni 3(5) thekson "*parimin e ndarjes së qartë në përcaktimin e përgjegjësitë*", në mënyrë që ndarja dhe caktimi i funksioneve administrative dhe detyrave, ndërmjet organeve, institucioneve dhe njësive administrative të jenë transparente dhe të bëhen publike.

Në bazë të nenit 5 të këtij ligji, është Këshilli i Ministrave që me propozimin e Kryeministrit përcakton fushën e veprimtarisë shtetërore e përgjegjësitë e çdo ministrie. Më tej, në këtë ligj përcaktohet se "*çdo ministri drejtohet dhe përfaqësohet nga Ministri, i cili është përgjegjës para Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit për tërësinë e veprimtarisë së Ministrisë*". Po kështu, në nenin 22 të këtij ligji theksohet edhe një herë se çdo ministër është përgjegjës për mbikëqyrjen e aktivitetit të ministrisë, institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore.

Nga përmbledhja e mësipërme vërehet një ndarje e qartë e kuadrit ligjor të hierarkisë dhe përgjegjësive të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave dhe Ministrave.

Konkretisht, Kryeministri propozon fushën e veprimtarisë, kompetencat dhe përgjegjësitë për një ministri në përputhje me vizionin e tij për politikat e përgjithshme të shtetit. Megjithatë, Propozimi i Kryeministrit duhet të shqyrtohet dhe vendoset nga Këshilli i Ministrave. Kjo do të thotë se fusha e përgjegjësisë së çdo ministri, nuk përcaktohet vetëm nga Kryeministri, por në fund të fundit përcaktohet nga një organ kolegjial, i tillë si Këshilli i Ministrave, i cili vendos me shumicën e votave të anëtarëve, duke njohur të drejtën e ministrave për të shprehur mendimet e tyre dhe për të votuar. Pasi fusha e përgjegjësisë miratohet nga Këshilli i Ministrave, drejtimi dhe përfaqësimi i ministrisë si institucion bëhet vetëm nga ministri përgjegjës.

Përveç Ligjit për Administratën Shtetërore, nëlidhje me këtëshqetësim është e rëndësishme të analizohet edhe Ligji i Këshilli i Ministrave, i cili siguron organizimin dhe funksionimin e këtij organi ekzekutiv.

Ligji për Këshillin e Ministrave sipas nenit 1 të tij, rregullon organizimin dhe funksionimin e "*Këshillit*

të Ministrave, Kryeministrit, Zëvendës-Kryeministrit, Ministrit, [...] marrëdhëniet e tyre dypalëshe, si dhe e aktet nënligjore". Ky ligj në mënyrë të ngjashme me Ligjin për Administratën Shtetërore, parashikon se Kryeministri, Ministri dhe Këshilli i Ministrave janë organe të ndara dhe të dallueshme nga njëri-tjetri.

Ndërkohë që detyrat e Kryeministrit janë të listuara në nenin 2 të këtij ligji. Sipas këtij ligji, Kryeministri "*a) përfaqëson dhe udhëheq kryeministrinë; b) kërkon raporte shpjegime dhe verifikime administrative nga ministrat përgjegjës për çështjet që ata mbulojnë; c) me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, Kryeministri pezullon zbatimin e akteve të ministrave, drejtuesve të institucionit qendror nën mbikëqyrjen e tij ose të ministrave, kur konstaton shkelje të Kushtetutës, ligjeve, ose të akteve të Këshillit të Ministrave*".

Kjo dispozitë përcakton si kompetencë të Kryeministrit, mundësinë që ai mund tu kërkojë shpjegime Ministrave, si dhe mundësinë për të pezulluar zbatimin e akteve të Ministrave, kur ka shkelje ligjore. Vlen të theksohet se, Kryeministrit nuk i është njohur në mënyrë eksplicite e drejta për të ndryshuar, të hequr, revokuar, ose shfuqizuar një akt të Ministrit, por e drejta e pezullimit të aktit të ministrit nga ana e Kryeministrit është megjithatë një e drejtë e rëndësishme që e siguron atë me kompetencën për të ndikuar në veprimtarinë e një ministri.

Gjithashtu, vlen të theksohet se pezullimi në vetvete është një ndërprerje e përkohshme e efekteve juridike të një akti, i cili pas pezullimit do të vazhdojë të prodhojë të gjitha efektet ndërsa revokimi i një akti do të thotë ndërprerje e efekteve ligjore, që si të tillë do të thotë një kompetencë më e madhe që ligji nuk ja ka atribuar Kryeministrit. Po kështu, duhet thënë se pezullimi i një akti të një ministri, duhet të bazohet në konstatimin se akti në fjalë ka shkaktuar shkelje të Kushtetutës, ligjeve dhe vendimeve të Këshilli i Ministrave, që do të thotë se pezullimi i një akti të ministrit mbetet relativisht kufizuar.

<u>Në përfundim të kësaj analize dhe në përgjigje të shqetësimit të Sekretariatit për këtë çështje, konkludohet se</u>:

1. Në lidhje me emërimin dhe shkarkimin e ministrit, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, parashikon një procedurë, e cila kërkon jo vetëm iniciativën e Kryeministrit por edhe marrëveshjen e Presidentit dhe votën miratuese të Kuvendit. Një procedurë e tillë, në teori jep një garanci për Ministrin në lidhje me stabilitetin e tij në ushtrimin e detyrës, në rast konflikti me Kryeministrin.

2. Kushtetuta i ka dhënë edhe ministrave një shkallë autonomie në marrjen e vendimeve në proceset vendimmarrëse për çështjet nën përgjegjësinë e tyre dhe që ndërmerren në kuadër të politikave të brendshme shtetërore të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

3. Pamundësia ligjore e Kryeministrit për të shfuqizuar një akt të Ministrit rezulton edhe nga dispozitat e ligjit për Këshillin e Ministrave, i cili i atribuon Kryeministrit vetëm të drejtën për të pezulluar një akt të një ministri, nëse ministri vepron në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e vendit.

4. Nga analizat dhe përfundimet e mësipërme, vlerësohet se kuadri kushtetues dhe ligjor në Shqipëri, lejon një nivel të caktuar të autonomia për ministrat gjatë ushtrimit të detyrave dhe kompetencave të tyre.

5. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh rolin politik të lidershipit të Kryeministrit në formimin e Këshillit të Ministrave, fuqia e tij në formimin e përgjithshëm të politikave të përgjithshme, e drejta e tij për të pezulluar përkohësisht një akt të një ministri dhe autoritetin për të zgjidhur mosmarrëveshjet ndërmjet ministrave, dhe duke e krahasuar atë me përvojën aktuale të politikës në Shqipëri, konsiderohet se do të ishte e pazakontë që në një rast të natyrës teknike të çojë në një konflikt në mes të një ministri dhe Kryeministrit, në rast se ky i fundit do të shprehë vullnetin për të rregulluar në një formë specifike një çështje, e cila është objekt i diskutimit.

Përveç sa më sipër duhet të theksojmë se niveli aktual i autonomisë së aktiviteteve të një ministri nga autoriteti i Kryeministrit varet nga një seri faktorësh të tjerë, të tilla si niveli i demokracisë në vend, shkalla e demokracisë brenda partive politike, shkalla e kontrollit dhe autoritetit që ushtron Kryeministri ndaj Ministrave te tij, rrugën politike e të karrierës, peshën dhe rëndësinë politike të një Ministri si dhe emancipimi i shoqërisë në përgjithësi.

4. Sekretariati, në një linjë me ECRB, i kërkon ERE që ndarja e pronësisë të zbatohet në të gjithë tregjet e gazit natyror dhe atij të energjisë elektrike.

Lidhur me këtë shqetësim të Sekretariatit, ERE parashtron se në bazë të Ligjit nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", Albgaz Sh.a. ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga veprimtaritë e tjera në Sektorin e Gazit, si prodhimi, tregtimi dhe furnizimi me gaz natyror, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

Aktualisht MZHETS (Ministria e Zhvillimit të Energjisë Tregtisë dhe Sipërmarrjes) rezulton aksionar i vetëm i Albgaz sh.a me kapital 100% shteteror, sic është përcaktuar ne VKM Nr. 848, datë 7.12.2016"*Për krijimin e shoqërisë Albgaz SH.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që për Përfaqëson Shtetin si Pronar të Aksioneve të Shoqërive të Albpetrol Sh.a dhe Albgaz Sh.a*". Në këtë mënyrë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ushtron kontroll të drejtpërdrejtë, në cilësinë e pronarit për Albgaz SHA.

Pra nga sa më sipër, si dhe duke qenë se aktiviteti i operatorit të kombinuar zhvillohen nga Albgaz sh.a. në formën e shoqërisë tregtare (shoqëri aksionare shtetërore), konkludohet se autoriteteti i përmendur më lart kryen funksionin e Asamblesë së Aksionarëve për shoqërinë Albgaz sh.a. duke marrë çdo vendim që ka në kompetencë Asambleja e Aksionarëve në një shoqëri aksionare sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901 datë14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", të ndryshuar.

Në këtë kontekst, vlen të theksojmë edhe njëherë se Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes janë dy institucione/organe të larta të administratës shtetërore të organizuara sipas ligjit nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*". Në bazë të ligjit nr. 90/2012, secila prej këtyre Ministrive kryen të gjitha funksionet administrative brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë shtetërore. Konkretisht, fusha përkatëse e përgjegjësisë për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë është përcaktuar në Vendimin nr. 833 datë18.09.2013 të Këshillit të Ministrave "*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë*", ndërsa për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes fusha e përgjegjësisë është përcaktuar nga Vendimi nr. 835 datë18.09.2013 i Këshillit të Ministrave "*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes*", të ndryshuar.

Për më tepër për sa i përket Albgaz sh.a., sipas VKM 848, datë7.12.2016, Ministria e Energjisë dhe Industrisë ushtron të drejtat mbi Albgaz sh.a. në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 102/2015, "*Për sektorin e gazit natyror*", si dhe në përputhje me fushën e saj të përgjegjësisë shtetërore.

Ndërkohë, në bazë të nenit 36 në pikën 2 të ligjit, përcaktohet se: "*Për të siguruar pavarësinë e ALBGAZ-sh.a. i njëjti person ose të njëjtët persona nuk kanë të drejtën që njëkohësisht:*

a) të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një të licencuar, që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror e të energjisë elektrike, dhe të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen ose ndonjë të drejtë tjetër ndaj Operatorit të Sistemit të Transmetimit apo rrjetit të transmetimit;

b) të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen apo të ushtrojnë ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror dhe të energjisë elektrike;

c) të emërojnë anëtarët e këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht Operatorin e Sistemit të Transmetimit apo rrjetin e transmetimit dhe, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen apo ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror dhe të energjisë elektrike;

ç) të jenë anëtarë të këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licencuarin pranë të licencuarve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit ose furnizimit të energjisë elektrike e të gazit natyror dhe veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose rrjetit të transmetimit".

Po kështu, në dispozitat vijuese të po këtij këtij neni, përcaktohet se :

"*4. Ndalimet e parashikuara në shkronjat "a", "b", c" dhe "ç", të paragrafit me sipër do të zbatohen në mënyrë të*

veçantë për:

a) kompetencën për të ushtruar të drejtën e votës;

b) kompetencën për të emëruar anëtarët e këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë të licencuarin;

c) të drejtën e mbajtjes së një pjese të shumicës së aksioneve.

5. Detyrimi i parashikuar me sipër, konsiderohet se është përmbushur nëse dy ose më shumë shoqëri, të cilat kanë rrjetet e tyre të transmetimit, kanë krijuar një sipërmarrje të përbashkët, e cila vepron si një operator i sistemit të transmetimit në dy ose më shumë shtete. Asnjë shoqëri tjetër nuk mund të jetë pjesë e kësaj sipërmarrjeje të përbashkët, përveç rastit kur shoqëria është përcaktuar si operator i pavarur i sistemit të transmetimit dhe është certifikuar sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

6. Kur personi i përmendur në paragrafin më sipër, është një organ publik që kontrollohet nga shteti, atëherë dy organe të veçanta publike që ushtrojnë kontroll, njëri mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe tjetri mbi të licencuarin që kryen funksionin e prodhimit ose të furnizimit të energjisë elektrike, do të konsiderohen sikur nuk janë i njëjti person".

Pra, konkretisht ashtu siç evidentohet më lart, në bazë të VKM Nr. 848 datë 7.12.2016 "Për krijimin e shoqërisë Albgaz sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik qe Përfaqëson Shtetin si Pronar të Aksioneve te Shoqërive të Albpetrol sh.a dhe Albgaz sh.a", rezulton se Ministria e Zhvillimit, Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes është mbajtëse e 100 % të aksioneve të Albgaz sh.a ndërkohë që MEI është 100 % aksionare e Albpetrol sh.a. të cilat ushtrojnë përkatësisht aktivitetin e operatorit të kombinuar të gazit natyror dhe prodhimit të gazit natyror.

Në këtë mënyrë për qëllime të ndarjes së pronësisë së Albgaz sh.a. sipas rekomandimit të Sekretariatit, ERE konsideron se kjo ndarje rezulton se është kryer sipas parashikimeve të nenit 80 të ligjit nr.102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", si dhe në përputhje me Rregulloren e Certifikimit, ku përcaktohet se, ndër kriteret që duhet të përmbushen nga aplikuesi për të mundësuar vendimmarrjen dhe certifikimin është detyrimi që personi juridik që ka pronësinë mbi Operatorin e Kombinuar të Gazit Natyror nuk duhet të ketë të drejta kontrolli të drejtpërdrejtë apo të tërthorte në aktivitetet e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit apo anasjelltas.

Përpos nevojës për të shtjelluar dhe për të monitoruar më tej çështjet e renditura më sipër, për qëllim të certifikimit të OST, Sekretariati në Opinionin e tij ka gjetur me vend t'i rekomandojë ERE që t'i imponojë disa kushte shtesë OST-së.

B – Sekretariati kërkon që ERE të vendosë disa kushte shtesë për certifikimin e OST.

1. Sekretariati fton ERE për të kërkuar nga OST që të zbatojë një program të pajtueshmë-risë si dhe të emërojë një zyrtar të pajtueshmë-risë.

Në Opinionin e tij, Sekretariati e konsideron të dobishme t'i kërkohet OST që të zbatojë një program të pajtueshmërisë dhe të emërojë një zyrtar të pajtueshmërisë. Në këtë drejtim, Sekretariati pajtohet me qëndrimin e ECRB e cila kërkoi që "*koncepti i ndarjes së pronësisë në pajtim me nenin 9 (6) të Direktivës Elektrike duhet të paktën të shoqërohet me raportim të rreptë te pajtueshmërisë dhe monitorim të vazhdueshëm rregullator*".

Kërkesa për Zyrtarin e pajtueshmërisë dhe programin e pajtueshmërisë duhet të realizohet në përputhje me neni 21 të direktivës së Energjisë Elektrike dhe duhet të përfshijnë të drejta të gjera që lidhen me vendimet e investimeve, dhe në veçanti detyrimin që të raportojë ne ERE-s dhe të publikojë në faqen e internetit një raport në lidhje me marrëdhëniet midis të dy organeve publike që kontrollojnë OST dhe KESH / OSHEE. Këto angazhime gjithashtu do të jenë në përputhje me nenin 8 (2) (r) të Rregullores së ERE-s për certifikimin.

Lidhur me këtë rekomandim të Sekretariatit, siç është përcaktuar në nenin 21 të Direktivës dhe në nenin 8.2, germa "r", të rregullores "Për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike", operatori i certifikuar duhet të krijojë dhe t'i dorëzojë autoritetit rregullator ERE për miratimin e saj, Programin e Pajtueshmërisë, i cili përcakton masat e marra për të siguruar përjashtimin e sjelljes diskriminuese dhe se informacionet e ndjeshme tregtare nuk do t'u komunikohen aksionarëve të saj.

Me qëllim realizimin e synimit që stafi të mos ndryshojë në kundërshtim me rekomandimet, ERE do të vendosë rregulla që punonjësit e OST që kanë pasur akses në informacione konfidenciale dhe/ose informacione të ndjeshme tregtare, ekonomike dhe financiare, të mos punojnë tek asnjë palë e tretë konkurrente për një periudhë 12-mujore pas largimit nga puna, me qëllim që të ruhen dhe të mos dëmtohen interesat tregtare, ekonomike dhe financiare të OST.

Ky synim është i mundur të realizohet në tre drejtime kryesore.

Së pari, OST të ketë detyrimin që t'i propozojë ERE për miratim, kategoritë e personave dhe/ose funksionet e tyre respektive, të cilat mund të preken nga ky kufizim.

Se dyti, OST të marrë të gjitha masat e nevojshme që të ndryshoje dhe të përditësojë kontratat e punës me kategorinë e punonjësve që mund të preken nga ky kufizim, duke e futur këtë kufizim në kontratat e tyre të punës.

Së treti, ERE të konsiderojë mundësinë që ndalimi i punësimit të këtyre personave të mund të vendoset në kriteret e licencave që ERE i jep operatorëve të tretë që operojnë në të njëjtin sektor me OST, duke respektuar afatin e kufizimit maksimal prej 12 muajsh që lejon Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, ERE vlerëson se Programi i Pajtueshmërisë duhet t'i dorëzohet autoritetit rregullator ERE, jo më vonë se 6 muaj pas caktimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë. Ndërkohë që Zyrtari i Pajtueshmërisë duhet të caktohet jo më vonë se 3 muaj pas miratimit të vendimit final të certifikimit.

Ky program pajtueshmërie do të trajtojë të paktën sa vijon:

i) Masat për parandalimin e sjelljes diskrimi-nuese në raport me pjesëmarrësit e tregut.

ii) Detyrat dhe të drejtat e punonjësve të OST sh.a., në përmbushjen e qëllimeve të Programit të Pajtueshmërisë.

(iii) Personi ose organi përgjegjës për monitori-min e Programit të Pajtueshmërisë dhe dorëzimin ne ERE, të raportit vjetor të pajtueshmërisë.

2. Sekretariati fton ERE-n t'i kërkojë OST-së të ofrojë të dhëna që Ministria e Energjisë nuk mund të propozojë miratimin (ose kundërshtimin) tek Këshilli i Ministrave të interkonjektorëve të rinj që do të ndërtohen nga OST, në bazë të legjislacionit përkatës primar ose sekondar.

Në lidhje me këtë kërkesë të Sekretariatit, ERE konkludon se diçka e tillë mund të realizohet nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimit ndërinstitucional të OST sh.a. dhe të Ministrisë së Ekonomisë për realizimin e ndryshimeve ligjore dhe nënligjore që lidhen me transferimin e kompetencave të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë tek aksionari i OST sh.a., Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes.

3. Sekreatariati fton ERE-n t'i kërkojë OST të ofrojë prova që Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes ka autoritetin ekskluziv për të dhënë opinione në ERE për planin e zhvillimit të rrjetit, në bazë të legjislacionit përkatës primar ose sekondar.

Ashtu siç është shpjeguar më lart, edhe për këtë shqetësim të Sekretariatit, ERE konkludon se diçka e tillë mund të realizohet nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimit ndër-institucional të OST sh.a. dhe të Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, për realizimin e ndryshimeve ligjore dhe nënligjore që lidhen me transferimin e kompetencave të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë tek aksionari i OST sh.a., Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes.

Në përfundim Sekretariati mbështet certifikimin e OST sh.a. në përputhje me Vendimin Paraprak te ERE-s, duke iu nënshtruar vërejtjeve të mëposhtme të cilat janë adresuar në paragrafët më sipër në këtë vendim.

Në mënyrë të përmbledhur Sekretariati kërkon që ERE:

a) shqyrtojë dhe monitorojë:

- Përputhjen me rregullat për ndarjen ligjore dhe funksionale të Operatorit të Tregut dhe mënyrat e përfshirjes së OST tek bursa e energjisë elektrike në të ardhmen;

-Nëse Ministria e Ekonomisë dhe ajo e Energjisë kanë miratuar buxhetin e OST-së dhe të KESH/OSHEE;

-Rolin e Këshillit të Ministrave dhe të Kryeministrit në lidhje me Ministritë e Ekonomisë dhe të Energjisë;

-Aplikimin e rregullave të ndarjes në sektorët e energjisë elektrike dhe të gazit natyror dhe zbatimin e tyre në Shqipëri.

b) të vendosë kërkesa të tjera për kompaninë OST (brenda një afati kohor jo më tepër se 12 muaj) që kanë të bëjnë me:

-zbatimin e programit të pajtueshmërisë dhe emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë;

-të ofrojë të dhëna që Ministria e Energjisë nuk mund të propozojë miratimin (ose kundërshtimin) tek Këshilli i Ministrave të interkonjektorëve të rinj që do të ndërtohen nga OST, në bazë të legjislacionit përkatës primar ose sekondar;

-të ofrojë prova që Ministria e Ekonomisë ka autoritetin ekskluziv për të dhënë opinione në ERE për planin e zhvillimit të rrjetit, në bazë të legjislacionit përkatës primar ose sekondar.

Sipas nenit 3 të Rregullores për Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, në referencë të sa më sipër parashtruar, ERE duke marrë në konsideratë edhe Opinionet e mësipërme të Sekretariatit ka vendosur adresimin e tyre në vendimin përfundimtar në lidhje me certifikimin e OST sh.a.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 15 Mars 2017,

VENDOSI:

1. Miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC.

2. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për qëllime të implementimit të parashikimeve të nenit 8, pika 2, germat "c", "f" dhe "l", dhe p, të "Rregullores për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit për energjinë elektrike", OST sh.a., të paraqesë në ERE dëshmi që tregon garancinë në lidhje me:

- <u>Pavarësinë e audituesit financiar</u>. Audituesi financiar i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike duhet të jetë i pavarur, në kuptimin që audituesi financiar nuk mund të jetë i njëjti subjekt që kryen auditimin e ndërmarrjeve /sipërmarrjeve që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike. Në lidhje me këtë çështje, OST sh.a. duhet t'i kërkojë Asamblesë së Përgjithshme (MZHETS) sigurimin e shmangies së emërimeve të audituesve financiarë të njëjtë.

- <u>Mostransferimi i stafit.</u> Mostransferimi i stafit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike të ndërmarrjet/sipërmarrjet që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike, dhe në lidhje me qëllimin për të vendosur detyrimin që një kategori e caktuar punonjësish nuk do të mund të punojë pranë kompanive të tjera konkurrente për 1 vit, OST sh.a. do të rishikojë aktet aktuale dhe do të përpunojë rregulla të reja për marrëdhëniet e punës që sigurojnë përmbushjen e këtij kushti për një periudhë 1-vjeçare, dhe kompensimin financiar të punonjësit ndaj të cilit zbatohet ndalimi i transferimit.

- <u>Ndarja e Operatorit të Tregut</u>. Për realizimin e këtij qëllimi, OST sh.a. duhet të marrë masat paraprake dhe të bashkëpunojë brenda kompetencave të saj për realizimin e detyrimeve ligjore të përcaktuar në ligj, për sigurimin e përmbushjes së detyrimit për ndarjen financiare dhe ligjore të Operatorit të Tregut, siç është parashikuar në nenin 57/2 të ligjit nr. 43/2015, "*Për sektorin e energjisë elektrikë*", në përputhje me rregullat e tregut të miratuara nga ERE dhe në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave për ndarjen e Operatorit të Tregut.

- Bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimi i kompetencave tek Ministria e Ekonomisë. Për përmbushjen e këtij detyrimi, OST sh.a. do ti paraqesë ERE provat dokumentare që ndryshimet ligjore dhe nënligjore të nevojshme që lidhen me transferimin e kompetencave të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë tek aksionari i OST sh.a., Ministria e Ekonomisë, kanë ndodhur janë efektive.

- Programi i Pajtueshmërisë dhe Zyrtari i Pajtueshmërisë. Për realizimin e këtij objektivi, OST sh.a. duhet që, jo më vonë se 3 muaj pas miratimit të Vendimit të Certifikimit, të caktojë Zyrtarin e Pajtueshmërisë subjekt i miratimit nga ERE, si dhe duhet qe te hartojë dhe t'i dorëzojë ERE-s Programin e Pajtueshmërisë jo më vonë se 6 muaj nga caktimi i Zyrtarit të Pajtueshmërisë, konform përcaktimeve të nenit 21 të Direktivës së Energjisë Elektrike dhe nenit 14 të "Rregullores për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit për energjinë elektrike".

3. Mospërmbushja e detyrimeve të përshkruara në paragrafin 2 me sipër nga ana e OST, sjell si pasojë rihapjen e procedurës së certifikimit në përputhje me nenin 14 të "Rregullave për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin nr. 154 datë 11.12.2015, të bordit të ERE-s.

4. OST sh.a., do të raportojë çdo 3 muaj tek ERE dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në lidhje me përmbushjen e detyrimeve te tij sipas këtij vendimi si dhe me ecurinë e procesit të transferimit të kompetencave nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes.

5. T'i përcjellë këtë vendim Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

6. T'i përcjellë këtë vendim OST sh.a, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Autoritetit të Konkurrencës.

KRYETARI
Petrit Ahmeti